



Lurimi Shpk

Bashkia Vau Dejës – Ekonomia Pyjore shosh 2

**Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
për periudhën 2024 - 2033**



Klient Bashkia Vau Dejës

Klient:	Bashkia Vau Dejës
Burimi i financimit:	Fondet e Bashkise Vau Dejës
Tipi i dokumentit:	Plani i mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Shosh 2
Konsulent:	Lurimi shpk
Data e përgatitjes së draftit	10 Dhjetor 2024

Ekipi i konsulencës		
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni
K-1	Vasillaq Mine	Statisticien pyjesh, Lurimi shpk
K-2	Endri Bala,	Ekspert GIS, Lurimi shpk
K-3	Jarosllav Alla	Zooteknik Specialist, vleresim kap.kullosore, Lurimi shpk
K-4	Hazis Porja	Specialist terreni, Lurimi shpk
K-5	Lutfi Miftari	Ekspert për vegjetacionin ,punimet e terrenit,Konsulenti Lurimi shpk

Kodi ALFIS:

Data e miratimit:

SHKURTESA

PMPK	Plan i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave
EP	Ekonomi Pyjore
PM	Plan Mbarështimi
NjA	Njësi Administrative
SHPPK	Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	8
I.1	Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave.....	8
I.2	Ecuria e punës dhe përgjegjësitë.....	8
I.3	Metodologjia e punës.....	8
I.4	Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK.....	9
II.	Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Rove	10
II.1	Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore	10
II.2	Pronësia, administrimi dhe organizimi.....	10
II.3	Vendndodhja gjeografike dhe administrative	11
II.4	Konteksti i Bashkisë dhe EkonomisëPyjore	12
II.5	Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore.....	18
II.6	Situata demografike dhe socio-ekonomike.....	18
II.7	Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore.....	19
II.8	Gjuetia dhe peshkimi.....	20
II.9	Infrastruktura rekreative dhe didaktike	20
II.10	Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje	21
III.	Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave.....	23
III.1	Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave	23
III.1.1	Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)	23
III.1.2	Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)	24
III.1.3	Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela	25
IV.	Përshkrimi i stacionit	25
IV.1	Klima	25
IV.2	Topografia dhe morfologjia	28
IV.3	Gjeologjia.....	31
IV.4	Tokat	33
IV.5	Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë.....	33
IV.6	Erozioni nësipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore	36
IV.7	Rrëshqitjet e tokës.....	36
V.	Vegjetacioni dhe biodiversiteti.....	37
V.1	Brezat bio-klimatikë.....	37

V.2	Pyjet dhe kullotat	37
V.3	Tipet pyjore.....	38
V.4	Tipet e kullotave	39
V.5	Tipet e vegjetacionit potencial	39
V.6	Biodiversiteti.....	42
V.7	Prania e vlerave të larta mbrojtëse	43
V.8	Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin	43
V.9	Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore.....	44
VI.	Rrugët dhe infrastruktura.....	45
VI.1	Rrugët pyjore.....	45
VI.2	Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës	45
VII.	Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat.....	45
VII.1	Analizimi i të dhënave për pyjet	45
VII.1.1	Analizimi i tipeve pyjore	45
VII.1.2	Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes.....	47
VII.1.3	Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit	48
VII.2	Analizimi i të dhënave për kullotat.....	58
VII.2.1	Gjendja e kullotave	58
VII.2.2	Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore.....	59
VII.2.3	Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike	60
VII.2.4	Mbërritshmëria	60
VII.2.5	Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota	61
VIII.	Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave.....	61
VIII.1	Rezultati i inventarizimit në pyje	61
VIII.1.1	Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve	61
VIII.1.2	Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë	62
VIII.1.3	Struktura vertikale	63
VIII.1.4	Cilësia e lëndës drusore në këmbë	64
VIII.1.5	Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)	65
VIII.1.6	Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit	66
VIII.2	Gjendja shëndetësore/fitosanitare	66

VIII.2.1	Drurët e tharë.....	67
VIII.2.2	Dëmtime të tjera	67
VIII.3	Prerjet e paligjshme.....	67
VIII.4	Rezultatet e inventarizimit të kullotave	67
VIII.4.1	Tipi dhe cilësia e kullotave.....	68
VIII.4.2	Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit	68
VIII.4.3	Numri aktual i blegtorisë	68
VIII.4.4	Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve	68
VIII.4.5	Infrastruktura aktuale.....	69
VIII.4.6	Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë.....	69
IX.	Objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave	69
IX.1	Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë	69
IX.2	Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave.....	70
IX.3	Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal	70
IX.4	Objektivat kryesore të PMPK.....	72
IX.5	Objektivat specifike për ekonominë pyjore	72
IX.5.1	Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës.....	73
IX.5.2	Objektivat specifike për tipet pyjore	73
IX.5.3	Objektivat specifike silvikulturore	73
IX.5.4	Objektivat specifike për kullotat.....	86
IX.5.5	Objektivat specifike për biodiversitetin.....	87
IX.5.6	Objektivat specifike për gjendjen shëndetësore	88
IX.5.7	Objektivat specifike për faunën e egër.....	88
IX.5.8	Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues.....	88
IX.5.9	Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës	91
IX.5.10	Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreativ	92
IX.5.11	Objektivat specifike për pyjet me status mbrojtës.....	92
X.	Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK	93
X.1	Mundësia vjetore e shfrytëzimit	93
X.2	Prerjet silvikulturore vjetore	95
XI.	Planifikimi	98
XI.1	Planifikimi vjetor i masave.....	98

XI.1.1	Masat në pyje	98
XI.1.2	Masat në kullota	98
XI.1.3	Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike	100
XI.2	Masat afatgjata.....	100
XI.2.1	Masat silvikulturore në pyjet trungishte	100
XI.2.2	Pyllëzimet dhe ripyllëzimet	100
XI.2.3	Masat e aplikuara në kullota	101
XI.2.4	Gjendja dhe masat në infrastrukturë	101
XI.2.5	Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike.....	102
XII.	Vlerësimi ekonomik	102
XII.1	Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat	102
XII.2	Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve	102
XII.3	Planifikimi i shpenzimeve	103
XII.4	Analiza shpenzime – përfitim	104
Shtojca 1		104
Shtojca 2:		110
Shtojca 3:		122
Shtojca 4:		133
Shtojca 5:		141
Shtojca 6:		142

I. Hyrje

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i këtij Plani Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave bashkiake brenda kufijve të **Ekonomisë Pyjore (EP) Shosh 2** për periudhën 2024 – 2033., duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Në këtë drejtim, ai synon të përcaktojë, përmes një qasjeje të integruar, pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullosore dhe nevojat bashkiake dhe palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre. Ndërkohë, qëllimi i ndjekur është krijimi i kushteve të përshtatshme për të rritur kapacitetin e stafit lokal dhe bashkiak për të zbatuar masat përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe duke rritur bashkërendimin dhe ndërveprimin. Për të garantuar zbatim dhe interpretim efikas, plani aktual i mbarështrimit është shkruar në një mënyrë të qartë dhe konçize dhe konkluzionet kryesore theksohen me shkronja të zeza.

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Pas firmosjes së kontratës puna filloi me grumbullimin e dokumentave të nevojshëm për hartimin e planit të mbarështrimit si: planin e vjetër të inventarizimit, hartat e ekonomisë pyjore, studimet e mëparshme si: Planin e zhvillimit Vendor i Bashkisë Vau Dejës etj dhe dokumentat që lidhen me aspektin ligjor në fushën e pyjeve si:

- Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

Përgjegjësia për kryerjen e punimeve të terrenit dhe hartimin e planit të mbarështrimit ka qenë e kompanisë **Lurimi shpk**. Eksperti GIS pasi ndërtoi hartën pyjore të ngastrave dhe nengastrave pyjore ndërtoi rrjetin e sipërfaqeve prove i cili u pasqyrua në harte dhe në ortofoto dhe me pas pikat e këtij rrjeti u hodhën në GPS ku me pas filloi puna e terrenit e cila zgjati për një periudhë 3 muaj deri në muajt Korrik-Shtator. Pas përfundimit të matjeve në terren puna vazhdoi me përpunimin e të dhënave dhe me shkrimin e raportit të planit të mbarështrimit.

I.3 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji në përputhje të plotë me përshkrimet në **Udhëzuesin e Planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019**. Në fakt është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.

Analiza e palëve të ndryshme të interesit për hartimin e planit të mbareshtrimit jepet më poshtë:

Palët e interesit	Interesi	Aktivitetet
Banorët (me qëndrim të përhershëm, emigrantët dhe përdoruesit e pyjeve)	-Mbrotjtja dhe zhvillimi i pyjeve -Sigurimi i të drejtave ligjore për përdorimin e pyjeve dhe kullotave	-Prodhimii druve të zjarrit, lëndës drusore për ndërtimin e shtëpive, mbledhja e frutave të pyllit & bimëve mjekësore dhe kullotja e bagëtive.
Vjelësit e produkteve pyjore jodrusore	-Rritja e të ardhurave familjare	- Vjelja e frutave të pyllit dhe bimëve mjekësore.
Bashkia	-Mbarështrim i qëndrueshëm dhe shumëfunksional i pyjeve në nivel lokal. -Zhvillimi, ruajtja dhe administrimi i fondit pyjor nëpronësi të Bashkisë.	-Hartimi, zbatimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së PM. -Përgatitja e projekteve për investime për fondin pyjor të Bashkisë. -Ofrimi i mbështetjes teknike dhe këshillimore për pronarët, përdoruesit dhe shoqatat e pyjeve. -Bashkëpunimi me Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe organizata të tjera të shoqërisë civile. -Garantimi i përfshirjes së komuniteteve lokale në administrimin dhe mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave.
Bizneset e bazuara në prodhimet pyjore jodrusore	-Fuqizimi i zinxhirit të vlerës së prodhimeve pyjore jodrusore	-Kultivimi dhe grumbullimi i bimëve të ndryshme dhe bimëve mjekësore. -Eksportimi i bimëve.

Gjate kryerje se punimeve te terrenit, ekipi i kompanise Lurimi ka patur kontakte te vazhdueshme me stafin e pyjeve te bashkise Vau Dejës ku kane shkëmbyer mendime dhe jane informuar per punen e kryer ne vijimesi.

I.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit pjesmarrës, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Vau Dejës në fillim të aktiviteteve ishte:

- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për **EP Shosh 2** sipas kadastrës dhe AIFIS;
- Plani i mëparshëm i Mbareshtimitte **EP Shosh 2 i vitit 1978**.
- Te dhena demografike sipas fshatrave brenda territorit te ekonomise pyjore
- Plani i Zhvillimit Vendor i Bashkise Vau Dejës
- Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;
- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;

- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigitëve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.;
- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore SHOSH 2

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

- Bashkia Vau Dejës;
- Ekonomia Pyjore **Shosh 2**;
- Sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore Shosh 2, bazuar në VKM nr. 684, 2.09.2020: kaluar në pronese të bashkisë Vau dejes është **1969.21 ha**
- Vlefshmëria e PMPK: 2024 – 2033 (10 vjet);
- Planet e mëparshme që u ka mbaruar afati:
- -Mbareshtimitte **EP Shosh 2** i vitit **1978**
-

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

Pronësia dhe situata e përdoruesve në të shkuarën

Gjatë periudhës 1900 – 1944, pyjet dhe kullotat ishin kryesisht pronë e pronarëve të mëdhenj dhe pjesa e mbetur, e banorëve të fshatrave. Pyjet dhe kullotat e fshatrave përdoreshin individualisht, duke respektuar kufijtë dhe traditat e vjetra, ndërkohë fshatarët mund të hynin në pyjet privatë për kullotje të bagëtive ose për lëndë drusore në këmbim të taksës ose punës që do duhet të kryenin. Për periudhën 1945-1990 pyjet dhe kullotat e kësaj ekonomie pyjore administroheshin nga shteti dhe përdorimi i tyre ishte i përbashkët dhe i kushtojë interesave të shtetit. Planet e mbarështimit dhe të inventarizimit të pyjeve dhe kullotave hartoheshin nga stafet e Drejtorive të Sherbimit Pyjor Shtetëror dhe miratoheshin nga Keshilli Teknik i kësaj drejtorie. Keto plane hartoheshin pa u këshilluar paraprakisht me komunitetet lokale. Pas kësaj periudhe, politikat pyjore dhe kullosore filluan të nxisin përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje dhe zbatimin e PMPK-ve. **Kjo rezultoi në një proces decentralizimi, ku Qeveria e transferoi pronësinë mbi pyjet dhe kullotat dhe përgjegjësitë lidhur me to tek njësitë e qeverisjes vendore.**

Në lidhje me kuadrin ligjor, Ligji nr. 57/2020 "Per Pyjet", Kreu IV, neni 16.

- Bashkia zhvillon strukturën e saj menaxhuese, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorial administrativë (neni 16,pika 3)
- Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve lokalë ndërmerret nga Bashkia.
- Përgatitja e planit të mbarështimit për pyjet dhe kullotat i ngarkohet stafit të Bashkisë.


Por, **Bashkia Vau Dejës** duhet të ketë fuqi dhe të sigurojë mjete të nevojshme mbi kontrollin e territorit të ekonomisë **Shosh 2**. Përdorimi i pyjeve dhe kullotave (shfrytëzimi i druve të zjarrit, kullotja, prodhimi i gjetit dhe bimëve mjekësore/frutave pyjore) duhet të planifikohet në lidhje me mbarështimin, si edhe kontrollin e tyre brenda EP **Shosh 2**.

II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

Numri i parcelave dhe n/parcelave, si edhe ndarja e sipërfaqes në pyje, shkurre, kullota dhe inproduktive jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm (burimi VKM Nr. 684, datë 2.09.2020):

Numri i parcelave dhe n/parcelave	EP Shosh 2 (ngastra/nen ngastra)	Sipërfaqja(ha)
Tokë pyjorë	Nr. I ng. e nën ngastrave 106	1497.09
Tokë kullimore	Nr. I ng. e nën ngastrave 9	35.09
Inproduktive	Nr. I ng. e nën ngastrave 20	437.03
Gjithsej	Nr. I ng. e nën ngastrave 135	1969.21

NDARJA E SIPERFAQE SE EK.PYJORE SHOSH 2



II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Bashkia e re Vau-Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e Bashkisë është qyteti i **Vaut të Dejës**.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë **Vau Dejës**, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij Ligji ku shprehimisht thuhet : **Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit** pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.* Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor dhe kullosor është ligji nr 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kështu në administrim të **Bashkisë Vau Dejes** kalon fondi pyjor/ kullosor i bazuar në VKM nr 433 dt 08.06.2016. i ndryshuar me vkm nr. 684, date 02.09.2020 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive” **pika 49**.

Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.


Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik për prodhimin e lëndës së drurit dhe druve të zjarrit, punësimin në zonën rurale, në shërbimet mjedisore si reduktimi i dioksidit të karbonit, zbutja e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet, zbutet klima, reduktohet dioksidi i karbonit, pasi thithet nga pemët nëpërmjet fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kjosës ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet janë dakordësuar të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektiv arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kreditë karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni. Pyjet kryesore, gjenden në zonën malore të Bashkisë, në brigjet e lumenjve Drin, dhe Shale. Në sipërfaqen pyjore dominojnë pyjet e larta bredhi dhe pisha, shkurre të ndryshme. Në kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rrëshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe vijes bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike dhe vijes bregdetare. Sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e situatës aktuale. Njësitë Administrative nevojitet që nëpërmjet planeve të

menaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund ti ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. Një-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Referuar vendimit të mësipërm , të dhënat e fondit pyjor/kullosor qe kanë kaluar në pronësi dhe administrim nga BASHKIA VAU DEJËS janë: **31,118.2 ha e ndarë si më poshtë:**

- Siperfaqe të veshura me pyje 24,812.01 ha
- Kullota..... 2,959.89 ha
- Ranishte..... 293.46 ha
- Shkëmbore/Inproduktive..... 3052.84 ha


Më poshtë ,përdorimi i territorit jepet sipas grafikut



Siperfaqet sipas njësive administrative jepen si më poshtë:

Njësitet administrative	Bushat	Vig Mnelë	Temal	Shllak	Hajmel	Vau-Dejës Total	Totali
Sipërfaqja(km ²)	99	73	101	72	31	99	475

Harta e Njësive Administrative



Më poshtë janë treguar distancat e qytetit të Vaut të Dejës nga qendrat administrative kryesore të vendit dhe rajonit:

20 km nga Shkodra

35 km nga Lezha

40 km nga Velipoja

44 km nga Porti i Shëngjinit

47 km nga Ulqini

69 km nga Podgorica

80 km nga Aeroporti Rinasit

94 km nga Tirana

BASHKIA VAU-DEJËS

105 km nga Durrësi (Porti i Durrësit)

147 km nga Kukësi

220 km nga Porti i Vlorës

261 km nga Prishtina

Topografia dhe relievi

Vau Dejës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Zona Gjeografike: Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30,438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 50145 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 475 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra të paraqituara në pasqyrë dhe hartë si më poshtë:

Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censurit 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM
Vau Dejës	Qytetet Vau Dejës, Fshatrat; Mjeda, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë,			
Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
Vig Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e			

E veçantë për këtë Bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, Komanit një pjesë e konsiderueshme e të cileve gjendet brenda territorit administrativ të Bashkisë; Lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

Pozicioni Rajonal I Bashkise Vau Dejës.



II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Konsideratat historike të dhëna në pjesët e mësipërme në nivel të Bashkisë Vau Dejës janë të rëndësishme për EP Shosh 2. Duke iu referuar Planit të mëparshëm të Mbareshtimi per EP Shosh 2, mund të jepet një përmbledhje e shkurtër e situatës dhe mbarështrimit për atë periudhë.

Ndarja sipas perdorimit funksionit	Planit të mëparshëm të Inventarizimit per EP Shosh 2 se bashku me bashkine shkodër		Bashkia vau dejes	
	Sip ha	%	Sip ha	%
Pyje prodhues	3301.75	71	1493.26	75.8
Pyje mbrojtës	0	0	0	0
Siperfaqe shkembore	1086.02	23.33	437.03	22.2
Siperfaqe boshe	134	2.88	3.83	0.2
Kullota	130	2.79	35.09	1.8
TOTALI	4651.77	100	1969.21	100

Si shihet nga tabele e mësipërme, ekonominë Pyjore shosh 2, është ndarë në dy pjesë sipas ndarjes territoriale të vitit 2014, ku sipas ngastrave pyjore e kullosore rezultojnë **1969.21 ha** Sipas VKm 433, i ndryshuar dhe **2,682.56 ha** në Bashkinë Shkodër.

Objektivat e përgjithshëm të PMPK-ve të mëparshëm theksojnë përparësinë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të pyjeve dhe kullotave, si psh. përmirësimin e rritjes vjetore dhe cilësisë duke siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe funksionet mbrojtëse (veçanërisht mbrojtjen ndaj tokës). Funksioni kryesor i tyre i kushtojë mbrojtjes së mjedisit dhe përmbushjes së nevojave të domosdoshme të përdoruesve (lëndë drusore, kullotë për bagëtitë, fruta pyjore).

Sikurse përmendet në seksionin e mëparshëm, **ky plan mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave është një domosdoshmeri pasi ka kaluar një kohë e gjatë që nga viti 1978 kur është hartuar ky plan mbarështrimi dhe gjendja e burimeve pyjore dhe kullosore ka ndryshuar shumë.** Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave në **EP Shosh 2** nuk mund të konsiderohet si rezultat i një mbarështrimi të qëndrueshëm dhe shumëfunksional, pasi presioni mbi burimet nuk mund t'i lejojë ata të ripërtërihen ose rimëkëmben në kushte të kënaqshme dhe po krijon një erozion të tokës në rritje. Megjithatë, janë kryer disa punime përmirësuese në pjesë të ekonomisë pyjore. Përveç kësaj, prerjet e paligjshme dhe presioni mbi burimet pyjore janë ulur dukshëm që prej hyrjes në fuqi të moratoriumit të pyjeve në vitin 2016 dhe për shkak të largimit të popullsisë.

II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Të dhënat që vijnë nga censusi, të konfirmuara në terren gjatë procesit pjesëmarrës dhe anketimit në terren, tregojnë që numri i banorëve të të gjithë fshatrave që gjenden brenda kufijve të **EP Shosh 2** është rreth 2650, që përfaqësojnë një total prej 798 familjesh.

Karakteristika kryesore që duhet theksuar është tendenca e qartë për rënien e shpejtë demografike, e cila ka nisur që në vitin 1991 për secilën grup moshë, gjini dhe klasë shoqërore nëpërmjet migrimit nga fshatrat në zonat urbane apo Greqi. Në disa zona të thella, kjo rënie shkon deri në pesë herë më pak banorë. **Prandaj, ky fenomen ka një ndikim madhor duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme presionin nga fshatrat mbi burimet pyjore dhe kullosore, ndonëse janë vërejtur shenja të presionit të lartë në disa zona në afërsi të fshatrave.**

Struktura demografike e popullsisë së Njesive Administrative brenda territorit të EP – Shosh 2 jepet hollësisht në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm (*burimi : Plani i Pergjithshem Vendor-Bashkia Vau Dejës, 2023*)

Nr	Njësia administrative	Nr. Familjeve	Nr. Banorë	Femer (nr)	Meshku (nr)	Nr. personave te afte për pune (nr)	Nr fam me ndihme ekno	Nr perersonave ne emigrim	Përdorimi tradicional i pyjeve (përbashkët,
1	Temal	798	2650	1351	1299	1060	130	850	
Totali		798	2650	1351	1299	1060	130	850	

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Tregtimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore për EP Karma përgjithësisht është i lidhur me përshkrimin e dhënë në pjesën II.4 në shkallë Bashkie.

Prodhimet drusore kryesisht përfaqësohen nga drutë e zjarrit dhe më rrallë nga prodhimet e tjera që lidhen me punimet pyjore (nga krasitjet apo rrallimet) të kryera nga fshatarët për nevojat e tyre. Përveç druve të zjarrit, çka përbën deri 85% të nevojave lokale, nga fshatarët mund të përdoren prodhime të tjera drusore, si material ndërtimi për ruajtjen e bazës ushqimore për bagëtitë dhe hunj gardhesh në tokat bujqesore. **Rezulton që tregtimi i prodhimeve drusore është i rrallë tek banorët.** Vlerësohet që tregtimi lidhur me shfrytëzimin e lëndës drusore për qëllim industrial ai mungon.

Nuk ka një strukturë reale pyjore dhe asnjë mekanizim të punimeve në pyje dhe niveli i aftësive profesionale të punëtorëve lokalë është i ulët. Megjithatë, punimet pyjore mund të jenë një perspektivë ekonomike në të ardhmen dhe banorët lokalë janë shprehur të interesuar për t'u përfshirë nëqoftëse u sigurohet trajnimi dhe punësimi. Por, situata aktuale është që prodhimi i druve të zjarrit për plotësimin e nevojave lokale përgjithësisht është i pjesisht i kontrolluar dhe mund të kryhet në çdo parcelë dhe në çdo kohë, pa racionalizim dhe bashkërendim ndërmjet komuniteteve lokale dhe shërbimit pyjor bashkiake. Materiali drusor për ndërtimet lidhur me bagëtitë (plevicat, gardhet) shfrytëzohet në grumbujt e mbetur të dushqeve dhe shkozës.

Prodhimet jodrusore gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi. Në zone ka mjaft specie pyjore dhe bime mjeksore që mund të grumbullohen dhe tregtohen pasi ka kërkesa në treg për to, por për shkak të mungesës së fuqisë punëtore ato nuk vlen dhe nuk përdoren si burim të ardhurash nga banorët.

Lidhur me blegtorinë, **Vau Dejəsi është një bashki me orientim blegtoralo-bujqësor dhe agroturistik, prandaj zhvillimi burimeve pyjore dhe të tjera natyrore duhet të ecë paralel me zhvillimin e turizmit.**

Kullotat verore dhe dimërore, të cilat përdoren nga blegtorët, përbëjnë një mundësi të mirë për plotësimin e nevojave të blegtorisë për bazë ushqimore. Produkti karakteristik i zonës është djathi i cili shitet në tregun vendas, por edhe në Tiranë.

II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia është një aktivitet i munguar dhe nuk gjeneron të ardhura. Kafshët karakteristike të kompleksit të faunës janë ujku, dhelpra, derri i eger, dhia e eger, kaprodhi, ariu i murmë, lepuri i eger, vjedulla, kunalle, zardaf, nuselale, shapkë, thellezë mali, bufi i malit, qukapiku, bilbili, harabeli. Vertebrorët janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët. Për më tepër gjitarët përfaqësohen edhe nga lakuriqi hundepatkua i Mesdheut (*Rhinolophus euryale*), lakuriqi hundepatkua i Blasit (*Rhinolophus blasii*) dhe lakuriqi i nates, veshmiu gishtëgjatë (*Myotis cappaccinii*), ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majmë i pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinus avellanarius*). Në lidhje me jovertebrorët, specie e rrezikuar është flutura (*Euphydryas aurinia*).

Me shumëllojshmërinë e habitateve të kësaj ekonomie takohen mjaft shpende si: Bufi - *Bubo bubo*, Huta bishtbardhë - *Buteo rufinus*, Gjeraqina këmbëshkurtër - *Accipiter brevipes*, Skifteri i Mesdheut - *Falco biarmicus*, Gjeraqina e shkurtës - *Accipiter nisus*, Gjeraqina - *Accipiter gentilis*, Qukapiku i përhimë - *Picus canus*, Kukuvojka mjekëroshe - *Tyto alba* dhe Skifteri kthetrazi - *Falco tinnunculus*, janë të pranishëm dhe indikatorë të gjëndjes së ekosistemeve të zonës. Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjtë, breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), dhe zhapiku i Gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Siç citohet shpesh në dokument kjo ekonomi pyjore ka një potencial të mirë për të zhvilluar aktivitete rekreative dhe turistike, veçanërisht lidhur me bukuritë natyrore të saj të cilat duhet të reklamohen dhe vizitohen nga turistët. Cilësia e peizazheve të ndryshme në brigjet e liqenit të Komanit, ofron mundësinë për të zhvilluar infraskuturën dhe objektet turistike, bazuar në ato ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku) dhe me qëllim zhvillimin e ekoturizmit dhe ngritjen e hoteleve dhe restoranteve ku të gatohen produktet e kuzhines lokale.

Megjithatë, **pengesa kryesore dhe mbizotëruese për zhvillimin e infrastrukturës turistike të përshtatshme është gjendja mesatarisht e degraduar e rrugëve deri në digën e Komanit. Theksohet se në të gjithë zonën nuk ka rrugë auto lidhëse, por transporti i banorëve bëhet nëpërmjet liqenit të**

Komanit me mjete lundruese. Në terma të përgjithshëm, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar ndërtimit të rrjetit rrugor që lidhin fshatrat e njesisë administrative, me qëllim për tu lidhur me liqenin e Komanit, si një parakusht për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave (jo vetëm për turizmin).


II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Në territorin e ekonomise pyjore Shosh 2, si zonë e mbrojtur është një pjesë prej 183.5 ha ,ku kjo përfshihet në parkun kombëtar të alpeve .Ghithashtu si monumente natyre janë edhe shpella e Malagjisë dhe blirët e lesniqes .

Ne afërsi të saj por jashtë territorit të kësaj ekonomie pyjore ka mjaft zona me vlera të larta natyrore. Territori i Bashkisë Vau Dejës, përfshin disa zona të mbrojtura, sikurse mund të shihet në "Hartën e Zonave të Mbrojtura të Vau Dejës". Në këtë listë është Parku Kombëtar "I alpeve" (kategoria II) në një sipërfaqe prej 183.5 ha, dhe 5 Monumente Natyrore (Kategoria III) siç janë :Shpella e malagjisë; Blirët në Lesniqe, Shpella e Cukalit, Rrapi i Toplanës dhe Shpella e Liqethit Cukal. Gjithashtu ka një seri gjeomumentesh në bashkinë Vau dejes si me poshtë:

Nr.	Emri i Gjeomonumentit	Bashkia	Njësia Administrative	Tipi	Kategoria
1171	Argjilat e vendburimit Bushat	VAU I DEJËS	Bushat	Mineralogjike	Lokale
1172	Vendburimi i argjilave Ranza	VAU I DEJËS	Bushat	Mineralogjike	Lokale
1173	Shpella e Cukalit	VAU I DEJËS	Shilak	Gjeomorfologjike-Karstike	Lokale
1174	Shpella e Muilqethit	VAU I DEJËS	Shilak	Gjeomorfologjike-Karstike	Lokale
1176	Mineralizimet e dausonitit-realgar-auropigmentit Koman	VAU I DEJËS	Temal	Mineralogjike	Kombëtare
1177	Fusha e Liqethit Gropa karstike e Mekzezes-Liqethit	VAU I DEJËS	Temal	Gjeomorfologjike-Karstike	Lokale
1178	Fusha Karstike e Vilës	VAU I DEJËS	Temal	Gjeomorfologjike-Karstike	Lokale
1180	Kanionet e Doçit	VAU I DEJËS	Temal	Gjeomorfologjike-Lumore	Kombëtare
1181	Marrëdhëniet e ofioliteve me serinë vullkano-sedimentare në Laç-Vau i Dejës	VAU I DEJËS	Temal	Tektoniko-Strukture	Kombëtare
1182	Prerja e Komanit	VAU I DEJËS	Temal	Tektoniko-Strukture	Nderkombetare
1183	Shpella e Malagjisë	VAU I DEJËS	Temal	Gjeomorfologjike-Karstike	Kombëtare
1184	Ujvarë nga Mali i Qerretit	VAU I DEJËS	Temal	Gjeomorfologjike-Lumore	Lokale

1.Zonat e Mbrojtura ne territorin e Bashkise Vau Dejës



Speciet karakteristike të zonës: *Quercus petraea*, *Quercus cerris*, *Quercus frainetto*, *Quercus trojana*, *Pinus nigra*, *Acer pseudoplatanus*, *Tilia argentea*, *Tilia cordata*, *Fagus sylvatica*, *Castanea sativa*, *Carpinus orientalis*, *Carpinus betulus*, *Ostrya carpinipholia*, *Fraxinus excelsior*, *Juniperus oxycedrus*, *Cotinus coggygria*, *Fraxinus ornus*, *Acer monspesulanus* etj.

Flora barishtore: *Equisetum* sp., *Pteridium aquilinum*, *Dactyloriza* sp., *Trifolium pratense*, *Vicia incana*, *Hepatica nobilis*, *Euphorbia amygdaloides*, *Geranium* sp., *Bellis perenis*, *Hierachum pilosella*, *Ranunculus* sp., *Urtica dioica*, *Cardamine bulbifera*, *Cirsium* sp., *Cheterac officinarum*, *Hedera helix*, *Potentilla* sp., *Oxalis pratense*, *Origanum vulgare*, *Melissa officinalis*, *Xanthium spinosum*, *Achillea nobilis*, *Achillea milepholiun*, *Mentha pulegium*, *Thymus serpyllum*, *Taraxacum officinale*, *Equisetum arvense* etj.


III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Sipas VKM nr. 684, dt. 2.09.2020, përdorimi i territorit në **EP Shosh 2** ,jepet në tabelën më poshtë. Duhet të theksohet që aty përfshihet i gjithë territori i njësisë administrative, jo posaçërisht vetëm territori i mbuluar nga parcelat e pyjeve dhe kullotave që janë inventarizuar dhe analizuar për PMPK aktual,(duke përfshirë dhe zonën e mbrojtur Pk. Alpeve).

Përdorimi i tokës (ha)	AIFIS	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështrimit 2024 (me zonën e mbrojtur)
Pyll	1214.92	1497.09	1683.9
Kullotë	23.93	35.09	28.3
Sip.Bimesi Pyjore	0	0	236.2
Djerre	0	0	0
Sipërfaqe inproduktive	437.03	437.03	2.0
Gjithsej	1675.88	1969.21	1950.4



Sipas pasqyres se mësipërme,diferencat e përdorimit të tokës ,nga plani i ri i mbarështimit me VKM ,është me pak prej 18.71 ha. Kjo rezulton nga korigjimi i hartës Pyjore dhe kufirit me Rrethin Shkodër.

Ndërsa nga programi alfis me planin e ri,rezulton një diferencë me e vogël prej 274.62 ha.Kjo si rezultat ,pasi alfis ka lenë jashtë sipërfaqe pyjore në afërsi të fshatrave dhe tokave bujqësore.

Nga të dhenat e tabelës kemi një rritje të sipërfaqes me bimësi pyjore me mbulesë 10-25 % prej 236.3 ha ,kjo e rrjellur nga sipërfaqia shkëmbore(inproduktive).Gjithashtu kemi rritje të sipërfaqes pyjore edhe kjo si rrjelloje e shtimit të sipërfaqes pyjore, po nga sipërfaqet e cilsuara në planin e mëparshëm si shkëmbore.

Nga krahasimi i të dhënave të VKM me ato të planit të mbareshtimit rezulton se ka diferenca të vogla në sipërfaqen e kullotave. Sipërfaqia inproduktive sipas VKM është e madhe ,por plani i menaxhimit i ka klasifikuar si tokë me bimësi pyjore,pasi shkalla e mbulimit është mbi 10%. Gjithashtu kemi rritje të sipërfaqe Pyjore.

Krahas këtyre të dhënave, duhet të theksohet që burimet pyjore dhe kullësore kanë qenë nën presion në të shkuarën (mbikullotje pa lejuar ripërtëritjen natyrore të pyjeve dhe duke zvogëluar mbulesën barishtore të kullotave) me pasoja degradimi, erozioni të tokës dhe në prodhimtari. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të madhe demografike edhe numri i bagëtive, të cilat mbahen për nevojë vetjake të familjeve gjithashtu ka pësuar rënie në të njëjtin raport. Kjo shpie në një presion më të ulët mbi zonat pyjore. **Pra, nuk pritet dhe as rekomandohet të shihet një zvogëlim i përdorimit të tokës pyjore në të ardhmen.**

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Në tabelën e mëposhtme jepet sipërfaqja pyjore sipas regjimit të qeverisjes referuar planit të mbareshtimit të vitit 1978 dhe atij aktual. Nga krahasimi konstatohet se ka një ndryshim dhe këto **kane ardhur për shkak se një pjesë e pyjeve kanë kaluar në pronësi private(afërsi të tokave bujqësore,troje),si dhe një pjesë i kanë kaluar zonave të mbrojtura në sipërfaqe prej 171 ha pyje,kullota dhe inproduktive.**

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP	Plani i mëparshëm Inventarizimit_1978		PMPK aktual ,Vau Dejes	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	778.49	76	736	47.32
Cungishte dhe cung.e përbëre	691.07	0	792	50.97
Shkurre	23.7	0	2.5	0.17
Kullota , livadhe	35.09	0	21.9	1.41
Djerre	3.83	1.8	0	0
Improduktive	437.03	22.2	2.0	0.13
Gjithsej	1969.21	100	1554.4	100

Rekomandimet e planit aktual të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave synojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për inkurajimin sa më shumë të regjimit qeverisës trungishte, i cili nuk është përjashtues ndaj kullotjes në rrethana dhe periudha specifike të racionalizuara. Plani do të zbatohet duke shtuar pyllëzimin, i cili duhet të transformojë disa kullota të degraduara dhe toka të eroduara në toka pyjore, pa specifikuar një sasi përkatëse, për shkak të varësisë në sigurimin e fondeve dhe kapacitetit investues.

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Lista e të gjitha parcelave dhe n/parcelave me sipërfaqet përkatëse dhe përdorimin e tokës jepet në shtojcën 1.

IV. Përshkrimi i stacionit

IV.1 Klima

Njesia Administrative Temal, ku ben pjese dhe Ekonomia pyjore – **Shosh 2**, ndodhet 50 km larg qytetit te Shkodrës. Qendra e njesise Administrative është Komani dhe përshkohet nga rruga nacionale Shkoder –Koman.Qarkullimi për në ekonomine Pyjore **Shosh 2** bëhet nëpërmjet liqenit të komanit me mjete lundruese,pasi në të gjithë këtë zonë nuk ka rrugë auto.

Ajo është e formuar nga 11 fshatra me konfiguracione të ndryshme, të vendosura në zonën malore .Në përgjithesi kemi të bëjmë me zonën klimaterike mesdhetare Kontinentale, nënë zona veriore paramalore dhe malore.që përfshihen dhe përfshin tre zona fitoklimaterike.

- Zona fitoklimaterike e makjeve(nënëzona e ftohtë e saj,.)
- Zona fitoklimaterike Catanetum
- Zona fitoklimatrike Fagetum

Është një njësi administrative me të gjithë elementet e duhur për të qënë një zonë e banuar dhe të gjitha elementet së bashku formojnë një kompleks natyror shume të larmishëm.

Gjithë fshatrat e njësië administrative përfshihen brenda bazenit ujëmbledhës të lumit Drin,ku natyrisht ky bazen është i coptuar në mikrobazene, prej perrenjëve që e përshkojnë dhe ujin që mbledhin e derdhin të gjithë në lumin Drin . Pyjet dhe kullotat e kësaj njësie kufizohen Konkretisht;

Kufijtë

- **Veri**,Kufizohet nga kufiri ndarës me Njësine Administrative Shosh,rrethi Shkoder
- **Juge** :Nga kufiri ndares me Bashkine Vau dejes e Rr. Pukes
- **Lindje**:Me rrethin e Pukes(dhe liqenin e komanit)
- **Prendim**:Kufizohet me njësine administrative Shllak.

Klima si elementi kryesor për një zhvillim vegjetativ normal, është mjaft dashamirëse me komunitetin. Kemi të bëjmë me temperatura të moderuara, dhe mjaft të ndryshueshme, për faktin se pyjet dhe kullotat, sikurëse u theksuam më sipër shtrihen në tre nënëzona klimaterike dhe në tre zona fitoklimaterike, në atë Lauretum, Castanetum dhe pjesërisht Fagetum. Megjithë këtë, këto zona karakterizohen me dimer mesatare dhe pak a shumë të gjatë dhe me verë të thatë deri të fresket dhe mesatarisht të gjatë. Treguesit klimatrik të vlersura sipas fshatrave ato paraqesin larmi elementësh të ndryshëm. Por në tabelat e treguesëve klimatrik do të paraqesim tregues mesatarë më përfaqësues që koficientin e ndryshueshmërisë nuk e kanë shumë të ndjeshëm.

Më poshtë po japim temperaturat mesatare shumëvjeçare, të marrura nga tabelat e rakordura sipas lartësisë mbi nivelin e detit të Republikës për zonat veriore.


Temperaturat mesatare vjetore për lartësinë mesatare 650 m

Muajt	H,m	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh	Mes
T.m,sh.vjeçare	650	1.6	2.4	5.1	9.4	14.2	17.9	20.0	20.3	16.9	11.7	7.2	3.1	10.8
T,m max.sh.vjeçare	650	4.8	6.0	9.1	13.7	19.0	22.8	25.4	25.7	21.7	15.7	10.7	6.7	15.1
T.m.miniale sh.vj	650	-1.7	-1.1	1.1	5.2	9.4	12.8	14.7	15.0	12.1	7.4	3.6	-0.3	6.5


Reshjet janë një element tjetër klimatik po aq i rëndësishëm për botën bimore e shtazore. Në përgjithësi kemi të bëjmë me zonë me rreshje të dendura dhe të pasura me shpërndarje pak a shume normale dhe uniforme, megjithëse ndryshimi nga një zonë në tjetrën është i ndjeshëm. Edhe këtë tregues po e pasqyrojmë në tabelën e më poshtme, natyrisht treguesit mesatar për lartësi mesatare.

Rreshjet mesatare vjetore

Muajt	L.m.d	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh	Mes
Rreshje	650	282.7	229.2	194.6	187.8	136.0	102.4	65.1	89.8	142.8	229.3	323.7	338.9	2322.3



Nderprerje vegjetacioni	Vegjetacion	Nderprerje vegjetacioni
----------------------------	--------------------	----------------------------



Nderprerje vegjetacioni	Vegjetacion	Nderprerje vegjetacioni
----------------------------	--------------------	----------------------------

Nga analiza e klimogramave rezulton:

- Po ti referohemi Klimatogrames se temperaturave mesatare minimale periudha e vegjitacionit fillon ne fillim te Muajit Prillë dhe nderpritet ne fillim te muajit tetor
- Po ti referohemi klimatogrames se temperturave mesatare maksimale periudha e vegjitacionit fillon ne fundin e mujit mars dhe vazhdon deri ne funde te muajit Tetor.

Muajt më të nxehtë në zone janë qershori, korriku dhe gushti me temperatura mesatare ditore nga 24 deri në 26°C. Vlerat maksimale mesatare më të larta variojnë nga 26 në 36°C. Muajt më të ftohtë janë nga dhjetori deri në shkurt, me temperatura mesatare ditore nën 2°C. Reshjet mesatare vjetore variojnë nga 1700 deri në 2300 mm. Minimumi i reshjeve ndodh zakonisht gjatë muajve të verës (qershor, korrik dhe gusht) dhe maksimumi në nëntor dhe dhjetor. Numri i ditëve me shi varion nga 85 deri në 120 ditë

Si konkluzion te pergjitheshëm (mbi bazen e ketyre analizave) rezulton se periudha e vegjitacionit(fillimi i aktivizimit te lengjeve,qe njihet kur tempertura e tokes i kalon + 10 grade celcius)fillon ne 15 Mars dhe vashdon deri me 15 tetor .

Ngricat.

Ngricat jane një elemente shume i rëndësishëm në krijimin e një objekti të ri Pyllëzimi,mbjellje të ndryshme ashtu edhe në rritjen dhe zhvillimin e llojeve ekzistuese natyrore.Ato lozin role me rëndesi,bile roli i tyre arrin deri atje sa në disa raste bëhet frenues në rritjen dhe zhvillimin e një kulture kur ajo vendoset pa e studiuar mire rezistencen e tyre ndaj ketije fenomeni.Në keëtë zonë ngricat jane të pakta dhe zgjasim jo me shume se 20-40 dite në vit dhe këto ndërprera.

IV.2 Topografia dhe morfologjia

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e ngastrave te **EP Shosh 2** varion nga 180 m deri në 1480 m me një lartësi mesatare te pergjithshme ne nivel ekonomie pyjore prej 650 m mbi nivelin e detit.

Në këtë reliev ngrihen shpate të pjerrët, të cilët ndikojnë në mënyrë të ndjeshme vetitë e tokës dhe vegjetacionin e hasur. **Mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave në EP Shosh 2 duhet të integrojë si tepër të rëndësishëm funksionin mbrojtës ne ato ngastra ku pjerresia eshte e madhe.** Tabela dhe grafiku mëposhtëm japin të dhëna më të hollësishme. Ato veçanërisht tregojnë pjerrësinë mesatare prej 41-70% të EP Shosh 2. Sipas tabelës se meposhtem konstatojme se ne kete ekonomi shpatet me pjerresi mbi 11 % zene 100% te siperfaqe së ekonomisë pyjore.


Theksohet se totali i ekonomise(**pyje,kullota,B.Pyjore,Inproduktive,bujqesore,troje**) per Bashkine vau Dejes është **1824 ha.(jane hequr zonat e mbrojtura Te PK te alpeve 179.4 ha) .Totali me zonat e mbrojtura 2003.4 ha. Siperfaqe Pyjore është 1530.5 ha,ku siperfaqia e zonave te mbrojtura nuk eshte perfshire ne pershkrimet parcelare ne programin Axcas per pyjet e kullotat.**

Kjo jepet në tabelën më poshtë:

Nr.	Destinacioni sipas ndarjes territoriale	Totali Ha	Zona e mbrotjur Kat.II PK.Alpeve ha	Bashkia ha
1	Pyll	1683.9	153.4	1530.5
2	Kullote,	28.3	6.4	21.9
3	sip.bimesi pyjore	236.2	11.2	225
4	Shkembore	2.0	0	2.0
5	Bujq,troje	53	8.4	44.6
Total		2003.4	179.4	1824

Theksohet se në tabeleat në vijim do ti referohemi vetëm sipërfaqes e volumeve për Bashkinë Vau Dejës, pasi sipërfaqet dhe volumet e PK të Alpeve nuk janë përfshirë në llogaritjet në ArcGIS, por vetëm në matjet GIS.


Pjerresia (%)	Sipërfaqja(ha)	% EP Shosh 2
0-10	0	0
11-40	175.8	9.6
41-70	989.7	54.3
71-100	658.5	36.1
Shuma	1824	100



Duke marrë në konsideratë konfigurimin e përgjithshëm të ekonomisë pyjore, si edhe rrjedhën e përrenjve kryesorë rezulton që kundrejtimi dominues i ekonomisë pyjore është perendimor dhe jug lindor

Kundrejtimi	Siperfaqja(ha)	Perqindja
J	110.2	6.0
JL	133.1	7.3
JP	135	7.4
L	350.4	19.2
P	168	9.2
V	485	26.6
VL	329	18
VP	113.3	6.3
TOTALI	1824	100

Kundrejtimi I ekonomisë Pyjore Shosh 2



Në tabelën e mëposhtme në nivel ekonomie pyjore jepet sipërfaqja sipas kundrejtmeve të ngastrave pyjore dhe përqindja respektive:

Lartësitë mbi nivelin e detit, kundrejtmet dhe pjerrësitë e ndryshme krijojnë kushte të favorshme për tipe vegjetacioni biogeografike të ndryshme, nga niveli mesdhetar i mesëm deri në nivel malor. **Kjo siguron interes potencial për aktivitete rekreative, si psh.ecja malore dhe për peizazhin.**


IV.3 Gjeologjia

-Përshkrimi gjeologjik është bazuar në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000, botimi vitit 2004, në tekstin sqarues të saj si dhe Hartat gjeologjike Shkallë 1: 100.000 të qarqeve të botuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar.

Karakteristikat e shkëmbit amnor .Tokat e Pyjeve dhe Kullotave e ekonomise **Pyjore Shosh 2**, shtrihen mbi formacione Gjeologjike të shkëmbinjëve Sedimentar,në të cilën përfshihen shkëmbinjët tokëformuës që janë Gelqeroret dhe Shistet Argjilore flishet,ranorët etj.,Tokat që përfshihen në ekonomin pyjore **Shosh -2** janë të vendosura mbi formacionin gelqerore që i perkasin dy periudhave te eratemit mezozoik,e para i takon sistemit Kretak dhe perbehet nga gelqeror morodiste,dhe e dyta sistemit Juastik dhe u perket gelqeroreve me elipsatik gelqerore olitikës etj.,Këto të dytët janë të ndërthurur edhe me rreshpe argjilore.E veçanta e tyre është se kanë origjinë Vullkanogjene dhe janë të vendosura mbi formacione rreshpe,të cilët dallohen shumë për nga rezistenca ndaj erozionit,ndaj nuk kemi shumë probleme me erozionin në këto toka.Ka edhe shkëmbinjë Gëlqerore që janë më të hershëm dhe si pasojë e amortizimit nga faktoreve klimaterik janë me të prekëshme ndaj erozionit.Gjithashtu në forme vijash takohen Gëlqerore neorodik të sistemit kretik,gëlqeror elifatik te sistemit jurasit.Formacionet amnore e pjesës së poshtëme i perkasin sistemit triastik seksioni i sipërm dhe përbëhet nga gëlqerorë dolomit që janëmjafte rezistent ndaj fenomenit erudiv të agjenteve atmosferik.

Shkëmbi amnor gelqerore është i perhapur kryesisht në zonat pyjore të veshura me shkurre e pjeserisht me llojet bunge,qarr,në **45%** te sipërfaqes del në forme blloku të shkaputur,me përhapje jo uniforme,zë pjesët me të larta të ekonomisë,është gjysëm l zbrëthyeshëm dhe jo erodues .Mbi këto janë formuar toka të hijta e pjesërisht të kafejta.Në përgjithësi janë shkëmbinjë me veshje argjilore.

Shkëmbi amnore Argjilore është i perhapur kryesisht në pjeset e poshteme të ekonomise,mbi keto shkëmbinjë janë formuar tokat Kafejte dhe te kuqeremta.Mbi të cilat vegjetojnë kryesisht pyjet e pjeserisht te dushkut.Janë lehtësisht të erodura nga ujrat.



IV.4 Tokat

Në përgjithësi konfiguracioni i sipërfaqeve të këtyre pyjeve është malore. Ndër llojet drunore me kryesore të kësaj ekonomie janë Dushqet, Ahu, frasheri, panja e malit, por ka edhe lloje të tjera të mbjedhura në rruge artificiale si Pisha e zezë. Përhapje me të vogël kanë Shkurret, ku ndër llojet kryesore janë Shkoza, lajthia etj. Formacioni tokë formues, siç u përkthyer me lartësi janë Gëlqerorë me veshje argjile si dhe vete Argjiloret. Në përgjithësi tokat janë të thella që shkojnë deri në 1.5 m, sidomos ato argjiloret shkojnë edhe më thella deri në 2.5 m. Janë toka me strukture kokrrizore, të freskëta, me ngjyrë të murrme sidomos ato mbi të cilin vegjitojnë pyjet e ahut. Pjesa tjetër ka ngjyrë të kafejtë, mbi të cilin vegjitojnë pyje të dushqeve dhe të Geshtenjes. Janë në përgjithësi të frekëta, sidomos ato të murrmet pyjore, ruajnë lageshtirën, me tepër ato të kafejtat, me gjithë në sipërfaqe thahen me shpejtë nën veprimin e rrezeve të diellit, por në thellësi e ruajnë me tepër lageshtirën për arsye të ngjeshmerisë në horizontin B_1 . Për pasojë janë mjaftë të përshkuara nga një sistem rrënjorë i dendur sidomos në horizontet e sipërme, por rrenjet e druveve pyjore shkojnë dhe në thellësi. Lartësia mbi nivelin e detit të pyjeve është ndërmjet kuatave minimale 180 m dhe atyre maksimale deri 1500 m.

- **Reaksioni** i këtyre tokave është acid, deri lehtësisht acide, deri neutrale. Këto të fundit shtrihen në tipin gjenetik të murrme pyjore, me reaksion lehtësisht acide deri acide janë tokat e tipit gjenetik të kafejtë e veçanërisht ato të kuqërremta, mbi të cilin vegjitojnë Geshtenja dhe Dushku. Ndërsa ato neutrale e lehtësisht acide janë tokat e murrme pyjore, dallojnë dhe një brez të tokave të murrme pyjore karbonatike që reaksioni anion me tepër në sensin bazik.

- Nga njëri horizont në tjetrin kemi një stabilitet PH brenda të njëjtit profil.

- **Humusi** varion nga 3-5 cm dhe në diastoka me pak se 3, duke i vlerësuar këto toka si të pasura me humus.

- **Fosfori** ka vlera mesatare

- **Kaliumi**, si element ushqyes ka vlera mesatare në krejt ekonominë.

- **Potasi** Ka vlera të atilla që i vlerëson këto toka në mënyrë të pasur

- **Karboni** Arrinë vlera të pa konsiderueshme, si të tilla këto toka vlerësohen të varfëra në karbon.

- **Azoti** në disa profile ka vlera mesatare deri në të larta.

- **Cilesit fizike.** Këto toka janë subargjila të lehta (SAL) dhe Subargjila të mesme (SAM). Ka disa toka, ku përqindja e argjilës fizike është e lartë dhe tokat emërtohen AL.

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

Kushtet hidrogeologjike të territorit të Bashkisë Vau Dejës paraqiten në hartat hidrogeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000 dhe në atë me shkallë 1:100.000. Kjo zonë karakterizohet nga prania e tre tipeve shkëmbinjsh me karakteristika hidrogeologjike krejt të ndryshme: shkëmbinj magmatikë,gëlqerore, shkëmbinj flishorë dhe dhera zhavorrore-argjilore. Shkëmbinjtë gëlqerorë përmbajnë rezerva të mëdha ujërash nëntokësore dhe shrtihen ne afersi te liqenit të Komkanit. Ata ndërtojnë pjesën jug lindore te ekonomise **Pyjore Shosh 2**. Gëlqerorët kanë çarshmëri të lartë si dhe janë të karstëzuar gjë që manifestohet me hapësirat e mëdha karstike që ato përmbajnë si karie, hinka dhe shpella karstike. Si rezultat infiltrimi i rreshjeve atmosferike në to është i lartë, zakonisht mbi 50% e rreshjeve shkon për ushqimin e ujërave nëntokësore karstike.Gëlqeroret zëne sipërfaqen më të madhe të ekonomisë Pyjoreshosh 2.Shkëmbinjtë e tjere zënë një sipërfaqe me te vogel dhe karakterizohen si ujembajtës në shtresat e tyre me përmbajtje argjile. Kjo rezulton që ku në të gjithë zonën të ketë burime ujore gjatë gjithë vitit,të mjaftueshme për komunitetin e zonës ,si për ujë të pijshem ,ashtu edhe për vadtje.

Ka një pjese të vogel të Flisheve ,ku paraqiten si shtresa ujë-izoluese dhe nuk përmbajnë rezerva ujërash nëntokësore të rëndësishme. Vetëm në rastet kur shtresat ranore paraqiten më të trasha ato përmbajnë rezerva ujore të vogla dhe formojnë burime zakonisht me prurje rreth 0.1-03 l/s. Keto formacione flishore ndjejnë më së tepërmi mungesën e ujit.




Figure 2. Rrjeti hidrik ne ekonomine pyjore Shosh 2

Pellgu hidrologjik i Bashkisë Vau Dejës përbëhet nga lumi Drin(liqenin i Komanit) dhe nga lumi I Shalës dhe nga disa përrenj të që e ushqejnë atë. Prurja e lumit gjatë vitit është mjaft e ndryshme. Sipas të dhënave të “Hidrologjisë së Shqipërisë” – 1984, si dhe vërtetimeve të tjera, rrjedhja mesatare vjetore në koman është 340 m³/s. Prurjet maksimale të lumit Drin e shalë në liqenin Koman dhe të perrejnve të

tjere,luhaten ne maksimum rreth 800 m3/s ,kurse ato më të vogëlat janë rreth 80-100 m3/s në periudhën e verës.

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Sikurse përshkruhet në pjesët e mësipërme, erozioni nuk perben problem per ekonominë pyjore, por mbrojtja e tokës duhet te përfaqësoje një interes thelbësor. Dihet se erozioni pakëson sasinë e humusit organik dhe kufizon vetitë fizike dhe mekanike te tokes, duke çuar në një rënie të përgjithshme të pjellorisë së saj dhe duke ndikuar ne rritjen vjetore te pyjeve dhe kullotave. Faktikisht, reshjet e befta të shiut, shpesh në sasi të mëdha dhe me intensitet të lartë, shtrirja e formacioneve të buta sedimentare lehtësisht të gërryeshme dhe mbikullotja dhe degradimi i pyjeve gjenerojnë erozion aktiv dhe të thellë. Nuk ka te dhena ne lidhje me sasine e elementëve ushqyes qe largohen nga erozioni në këtë ekonomi pyjore.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit vendimtar të pjerrësisë në këtë fenomen. Shpatet me pjerrësi më pak se 5% janë më pak të rrezikuara nga erozioni, megjithatë për shpatet me pjerrësi 5-25% rreziku është mesatar dhe bëhet më i lartë kur pjerrësia është mbi 25%. Me një pjerrësi mesatare prej 25.2° (që i korrespondon 46%), ajo **pjesë e EP Shosh 2 mund të konsiderohet me rrezik të lartë erozioni.**

Kjo situatë ka një ndikim madhor nëmbarrështimin e pyjeve dhe kullotave për këtë plan. Roli parandalues që luan bimësia pyjore ekzistuese është i pari që sillet ndërmend: Kjo bimësi zvogëlon forcën goditëse të pikave të shiut mbi sipërfaqen e tokës, ruan dhe ngadalëson rrjedhjen sipërfaqësore të ujit të shiut, duke krijuar kushtet për t'u përthithur nga toka, duke e pasuruar tokën me lëndë organike, shmangur erozionin dhe rritur pjellorinë e tokës.

IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Në lidhje me kushtet e hasura, të cilat gjenerojnë një shkallë të lartë erozioni siç përshkruhet në pjesën IV.6, rrëshqitjet e tokës gjithashtu paraqesin një rrezik, veçanërisht kur janë në diskutim objekte të tilla si ndërtesa, diga dhe për aktivitetet që kryhen rregullisht nga banorët (tokat bujqësore). Në këtë aspekt, rrëshqitja e tokës është një çështje e rëndësishme por nuk kemi konstatuar raste në **EP Shosh 2.**

V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë

Ekonomi pyjore **Shosh 2** bën pjesë në ekorajonin e quajtur “Pyjet gjetherënës Ilirë” Pyjet gjetherënës ilire janë një ekorajon tokësor në Evropën Jugore, i cili shtrihet përgjatë bregut lindor të detit Adriatik. I përket pyjeve mesdhetare, pyjeve dhe biomësisë së shkurreve dhe është në mbretërinë Palearktike. Pyjet gjetherënës ilire shtrihen përgjatë bregut lindor të deteve Jon dhe Adriatik dhe zënë 40,600 km² në Greqinë Veriore, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni dhe Italinë Veriore rreth Triestes.

Ekorajoni kufizohet nga pyjet klerofile dhe të përziera të Egjeut dhe Turqisë Perëndimore e Greqi, pyjet e përziera të maleve të Pindit (në Greqi dhe Shqipëri), pyjet e përziera të maleve Dinarike (në Shqipëri, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni dhe Itali) dhe pyjet e përziera të Basenit Po (në Itali). Klima e ekorajonit është kryesisht e tipit mesdhetar të Köppen-it me verë të nxehtë deri në subtropikale të lagësht me dimër të lagësht (Cfa). Për shkak të games së gjerë të lartësive të këtij ekorajoni, lartësitë më të larta janë të mbuluara me pyje halore, me një bimësi të përzier gjethëgjërë dhe shkurre makie që shtrihen më poshtë.


Llojet mbizotëruese të zonave të poshtme përfshijnë lisat e ndryshëm si *Quercus frainetto*, *Q. pubescens*, *Q. cerris*, *Quercus trojana*, *Quercus macrolepis*, me pemë dhe shkurre të tjera gjetherënës si *Carpinus orientalis*, *Fraxinus ornus*, *Cotinus coggygia*, *Paliurus spina-christi*, *Cercis siliquastrum*. Pemë me gjelbërim të përhershëm dhe shkurre makie *Quercus ilex*, *Quercus coccifera*, *Pinus halepensis*, *Pinus pinea*, *Pistacia terebinthus*, *Pistacia lentiscus*, *Erica arborea*, *Juniperus oxycedrus*, *J. macrocarpa*, *Olea europaea*, *Arbutus unedo*, *A. andrachne*, *Nerium oleander* të cilat dominojnë afër bregdetit.

Ekorajoni i pyjeve gjetherënës ilire është përcaktuar nga EEF dhe Harta Dixhitale e Rajoneve Ekologjike Evropiane nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. Fitogjeografikisht, ekorajoni ndahet midis provincave të Adriatikut dhe Mesdheut Lindor të Rajonit të Mesdheut Brenda Mbretërisë Holarktike.

V.2 Pyjet dhe kullotat

Ndarja e përgjithshme ndërmjet pyjeve, shkurreve, kullotave dhe të tjera (sipërfaqe shkëmbore, djerrë, rrjeti hidrologjik, sipërfaqe ujore ...) në EP Shosh 2 paraqitet më poshtë. Duhet përmendur që këto të dhëna i referohen vetëm parcelave, të cilat u inventarizuan në terren (ndryshe nga të dhënat e ofruara në pjesën III.1.1 për të gjithë njësinë administrative).

Sip. totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Bimesi Pyjore ha	Bimesi Pyjore (%)	Jo pyjore ha	Jo Pyjore (%)
1779.4	1530.5	86	21.9	1.23	225	12.65	2	0.12




V.3 Tipet e pyjeve

Në shkallë ekonomie pyjore, tipet e pyjeve shpërndahen siç tregohen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tipet e pyjeve jepen si me poshte:

Tipi i pyllit "Pyje të dominuar nga ..."	Sipërfaqja ha	% e totalit ndaj sipërfaqes pyjore	% e totalit të sipërfaqes së EP
Pyje te dominuar nga F.sylvatica	363.4	23.7	19.9
Pyje te dominuar nga Q.petraea	1136	74.3	62.2
Pyje te dominuar nga Pinus nigra e Quercus	28.6	1.9	1.6
Pyje te dominuar nga C.orientalis e quercus	2.5	0.1	0.1
Pyje te dominuar nga A.unedo			
Pyje te dominuar nga O.carpinifolia			
Totali	1530.5	100	83.8



V.4 Tipet e kullotave

Për shkak të lartësisë së madhe mbi nivelin e detit, të gjitha kullotat në EP **Shosh 2** janë kullota verore.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja ha	% of totalit të sipërfaqes kullosore
Kullotë verore	21.9	1.2
Kullotë dimërore		

V.5 Tipet e vegjetacionit potencial

1-Pyjet fletore termofil

Kjo klase dominohet nga speciet termofile fletore kryesisht të gjinisë *Quercus* ku dominojnë *Quercus trojana* dhe lloje të tjera shoqeruese si *Q.cerris*, *Q.frainetto*, *querqus petrea* dhe specie shoqeruese si *Carpinus orientalis* dhe *Arbutus unedo*. Keto lloj grumbujsh pyjore në shtrirjen e tyre jugore janë të kufizuar nga thatësira dhe në disa raste zëvendësohen nga fletore ose vegjetacion sklerofil.

mesdhetar. Prania e këtyre grumbujve pyjore shoqërohet me kushte të favorshme klimatike dhe edafike lokale.

Disa nga karakteristikat kryesore të përzierjes dhe specifikave strukturale të kësaj kategorie janë:

- **pasuria e shoqërimeve pyjore** të kësaj klase e cila dominohet nga 1-2 specie dominante vendase ose të natyralizuara të shoqëruara nga specie të tjera të nenpyllit. Si rezultat i aktivitetit human kjo përzierje është modifikuar duke çuar në eliminimin e specieve natyrore pa interes komercial ose me fuqi lastarizuese të dobët ose anasjelltas të futjes së specieve të tjera që nuk rriten natyrisht.

- **ndryshueshmëria e mbulesës pyjore dhe fizionomisë**: rritja e druveve dhe mbulesa pyjore variojnë nga pyjet me rritje të dobët dhe fragmentare në shumicën e zonave të thata ose zonave të degraduara, deri të drurët e shpërndara dhe me madhësi të plotë që duken si formacione savanash të mbjella artificialisht, deri të pyjet e zhvilluara dhe të mbyllura;

- **diferencimi i llojeve strukturore pyjore**: strukturat pyjore mjaft të thjeshtuara të formuara nga sistemet tradicionale silvikulturore janë më të zakonshmet (cungishte, cungishte me standarde, cungishte e përzier/pyll i lartë). Këto grumbuj pyjore janë habitate të rëndësishme për speciet që lidhen me cilësitë specifike të pyjeve të vjetra (p.sh. zogjtë folezues në vrmat e trungjeve të druveve, jovertebrorët që jetojnë në lëvore të trashë);

2. *Q.cerris*, *Q.frainetto* and *Q.petraea*

Lidhja me klasifikimin e habitateve EUNIS G1.7 — Thermophilous deciduous woodland

Grumbuj pyjore mbimesdhetar të larmishëm të karakterizuar nga përzierje të ndryshme të specieve *Quercus*, kryesisht *Quercus cerris*, *Q. frainetto*, *Q. petraea*, të shpërndara në të gjithë rajonin e Mesdheut duke u përhapur, në nivel lokal, në rajonet biogeografike Panonike, Kontinentale dhe Anadollit.

Pyjet kserofitike ose ksero mezofitike të *Quercus frainetto*, *Quercus cerris*, *Quercus petraea* dhe lisave gjetherënës, në vend të *Quercus pedunculiflora* ose *Quercus virgiliana*, të gadishullit të Ballkanit qendror dhe lindor subkontinental, me përjashtim të nivelit supra të Mesdheut, Greqisë. skaji jugor dhe i Anadollit supra mesdhetar. Në pjesën më të madhe të shtrirjes së tyre, ato përbëjnë shtresën më të ulët mbidetare të bimësisë pyjore; në Greqi dhe zonat ngjitur, megjithatë, ato ndodhin mbi pyjet e shoqërimeve *Ostrya Carpinion*.

3-Pyje fletore perhere te gjelber

Pyjet karakteristike të zonave mesdhetare dhe të ngrohta me lagështirë të rajoneve biogeografike të Makaronezisë, të dominuara nga specie sklerofile ose laurifile me gjelbërim të përhershëm. Shpërndarja gjeografike e kategorisë dhe karakteristikat e saj kryesore përkatëse kompozicionale dhe strukturore janë të specifikuara në përshkrimet e llojeve.

Marrëdhënia me Klasifikimin e Habitatit EUNIS G2.1 - pyll lisi mesdhetar me gjelbërim të përhershëm

4.Pyll lisi mesdhetar me gjelbërim të përhershëm

Zona pyjore e dominuar nga sklerofilët me gjelbërim të përhershëm si *Quercus coccifera*. Pyjet e dushkut me gjelbërim të përhershëm përbëjnë formacionin kryesor pyjor natyror të brezit mesdhetar të bimësisë mesdhetare, por sot shumë pak trakte plotësisht të zhvilluara kanë mbetur në Evropë. Shpërndarja dhe fizionomia e tanishme e drurëve të lisit me gjelbërim të përhershëm mesdhetar është rezultat i një ndryshimi të vjetër antropogjenik nga pastrimet, lastarizimi, zjarret dhe mbikullotja, duke rezultuar në zona të gjera të mbuluara sot nga fazat e degraduara të drurëve të lisit me gjelbërim të përhershëm: matoralet arboreshente, makja dhe garrigat.

5. Pyje të tjera sklerofile


Ky tip pylli përfshin formacione pyjore relativisht të vogla, me origjinë të ndryshme, të dominuara nga drurë sklerofilë që gjenden si nenpyll i pyjeve dushkaja me gjelbërim të përhershëm 9.1.1. Këtu përfshihen janë ndër të tjera trakte të pastra të species *Pistacia terebinthus* përgjithësisht mbi nënshtresa gëlqerore, që korrespondojnë me facialet e degraduara të pyjeve të lisit me gjelbërim të përhershëm, grumbujt pyjore me dafine (*Laurus nobilis*), ashe (*Ilex aquifolium*) dhe mares (*Arbutus unedo*).

6. Pyje me halore mesdhetare te rajoneve Anatolian and Makaronezian

Kjo kategori përfshin një game të gjere të pyjeve sklerofite të dominuar nga speciet halore (pisha, bredhi, dellinja, selvia, cedri) që gjenden në Mesdhe, dhe rajonet biogeografike Anatoliane dhe Makroneziane. Lidhja me klasifikimin e habitateve EUNIS është G3.7-Formacione pyjore halore të zonave të ulta mesdhetare

7. Pyll me pisha termofile

Pyll me pisha termofile e dominuar nga speciet termofile të gjine *Pinus* si: *Pinus pinaster* ssp. *P. pinea*, *P. halepensis*, *Pinus brutia*. Këto pyje pishë përbëjnë formacione pioniere termo-mesdhetare, të përhapura gjerësisht në brigjet dhe ultësitat e rajoneve rreth mesdhetare. Pyjet mesdhetarë të pishave janë në lidhje të ngushtë me pyjet fletore me gjelbërim të përhershëm mesdhetar, shumica e tyre janë pyje që shfaqen si faza të njëpasnjëshme ose zëvendësime plagioklimaksi të lisave perhere të gjelbër. Zjarri luan një rol të madh në rigjenerimin e pyjeve dhe dinamikën e pyjeve të *Pinus pinaster* dhe *P. halepensis*. *P. halepensis* veçanërisht, në mjedis me zjarre të përsëritura në pyje, tenton të krijojë komunitete të qëndrueshme 'piro-klimax'. Cenueshmëria e drurëve të pishës mesdhetare ndaj zjarrit në pyje ndikon gjithashtu, në mënyrë indirekte, në ruajtjen e habitateve të drurëve të vdekur: heqja e mbeturinave drusore është pjesë e masave për parandalimin e zjarreve në pyje. Pisha e eger është specia më me pak kërkesa nga pishat mesdhetare. Rritet në një gamë të gjerë tokash, mund të mbijetojë në toka shumë të varfra dhe të përballojë thatësinë e madhe. Sipas kushteve ekologjike lokale, lloje të tjera mund të shfaqen me pishën e eger, p.sh. Ilqja (*Q. ilex*) dhe shkoza e bardhe (*C. orientalis*). Në ekonomitë karmë jepen si me poshte:



V.6 Biodiversiteti

Mbrojtja e natyrës, biotopeve, habitateve dhe specieve të rrezikuara është pjesë procesit të mbarështrimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Këto elementë janë një instrument për përmirësimin e territorit me rëndësi për ruajtjen, por gjithashtu me ndikime potenciale pozitive socio-ekonomike.

Identifikimi i këtyre vlerave është bërë nëpërmjet disa burimeve si më poshtë:

- Përmbajtja dhe treguesit nga planet e mëparshme të mbarështrimit;
- Informacioni nga aktorët dhe banorët lokalë gjatë proceseve pjesëmarrëse;
- Vëzhgimet direkte në terren dhe mbledhja e të dhënave nëpërmjet matjeve në sipërfaqet provë;
- Raporti i vitit 2019 për kushtet e mjedisit nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.
- Dokumenti i politikave pyjore kombëtare të Shqipërisë 2019 – 2030 nga MTM.

Në përgjithësi, në territorin shqiptar gjenden 3250 specie bimore ose 29% e florës evropiane, një përqindje veçanërisht e lartë krahasuar me sipërfaqen relativisht të vogël të vendit. E thënë ndryshe, pavarësisht se Shqipëria përfaqëson 7% të gadishullit të Ballkanit, këtu gjenden 47% të florës së Ballkanit. Rreth 1% e kësaj flore i përket specieve endemike, ose ndryshe, janë specie që rriten vetëm në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë speciet sub-endemike (ato që shtrihen deri në vendet fqinje Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë Veriore, Greqi), ky raport arrin deri në 5% të florës shqiptare. Prandaj dhe, Shqipëria cilësohet si një nga vendet më të pasura në Evropë lidhur me biodiversitetin dhe endemizmin.

Bashkia e Vau Dejës, për vetë pozicionin fiziko-gjeografik, përmban të katër brezat/ zonat fitoklimatike që hasen në vendin tone: 1) Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare 2) Brezi i dushkajave 3) Brezi i ahishteve dhe 4) Brezi i kullotave alpine. Prania e këtyre brezave është një pasqyrim i madh i vlerave të florës, bimësisë dhe habitateve në këtë zonë

Në këtë kuadër, **Bashkia Vau Dejës është përfaqësuese e kësaj shkalle të lartë biodiversiteti dhe endemizmi**, ndonëse nuk përfshihet në sitet e biodiversitetit me prioritet parësor në nivel kombëtar siç përshkruhet në raportin e vitit 2019 të gjendjes së mjedisit nga AKM. Kjo përfaqësueshmëri është veçanërisht **për shkak të gamës së gjerë të kushteve bio-klimatike të hasura** (nga niveli meso kserofit mesdhetar deri në nivelin malor dhe sub-alpin) **në saje të lartësive të ndryshme, kundrejtmeve, relievit të fragmentuar, formacioneve shkëmbore dhe tokave.**

Sipas të dhënave të grumbulluara në terren në EP dhe krahas rezultateve të paraqitura në seksionin II.10, speciet endemike dominante që gjenden janë:

- *Origanum vulgare*, Euroaziatike;
- *Juniperus oxycedrus*, Mesdhetare Euri, heliofite;
- *Agrimonia eupatoria*, kozmopolite, heliofile;
- *Dryopteris filix-mas*, pothuajse kozmopolite.


Së fundmi, është e rëndësishme të raportohen vëzhgimet e drurëve të tharë, duke qenë se ata zakonisht shoqërohen me një nivel të lartë biodiversiteti lidhur me habitatet specifike të entomofaunës (*insektet*), avifauna (*shpendët*) dhe kiropterët (*lakuriqët*). Në kontekstin e EP Karmë është edhe më e dukshme që presioni mbi burimet drusore (shfrytëzimi, për qëllime familjare, kullotje, blegtori) ka qenë veçanërisht i rëndësishëm gjatë dekadave të fundit.

V.7 Prania e vlerave të larta mbrojtëse

Duke iu referuar listës të udhëzuesit të vitit 2018 në lidhje me vlerat e larta mbrojtëse (VLM) dhe krahas informacionit të raportuar mësipër (VLM rreth diversitetit të specieve), vëzhgimet nga sipërfaqet provë theksuan site të tjera me vlera të larta. Për ekosistemin dhe mozaikët e nivelit të peizazhit (HCV 2), u bënë vëzhgime specifike në ngastrat e kesaj ekonomie. Ne te ndeshen lloje me status mbrojtje (O carpinifolia) qe duhen ruajtur per vlerat qe kane.

V.8 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Duke iu referuar të dhënave në përshkrimin e parcelave dhe nën parcelave, mund të përcaktohet statusi aktual i elementëve ekzistues të biodiversitetit dhe llojete kërcënimeve. Kështu, **një rrezik specifik për biodiversitetin u vlerësua të jetë në 5.9% të sipërfaqes së përgjithshme të EP që përfaqëson një nivel jo të lartë.** Më hollësisht, llojet e rreziqeve dhe rëndësia e tyre krahasuar me njëri-tjetrin jepet përmes grafikut të mëposhtëm.



Për më tepër, duhet të theksohet se nga 6 ngjarje të raportuara gjatë inventarizimit në terren (p.sh. përgjatë rrugës nga sipërfaqet provë të përhershme tek ato të përkohshme), 4 prej tyre i përkisnin dëmeve nga zjarri dhe 2 prerjeve të paligjshme.

V.9 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Sipas bisedave të zhvilluara me Kryetaren e Bashkisë Vau Dejës, **u shpreh qartë dëshira për të zhvilluar funksionin turistik dhe rekreativ në EP Shosh 2**, megjithëse realizueshmëria e një projekti konkret nuk ishte studiuar saktësisht. Pavarësisht se EP **Shosh 2** dodhet relativisht larg qytetit të Vau Dejësit dhe rrugëve publike kryesore, mundësia duket e lartë për të vlerësuar peizazhin spektakolar të ofruar, mundësinë e shtigjeve për ecje malore dhe atmosferën rurale, duke zhvilluar një ofertë për ekonturizmin me përfshirjen e palëve të interesuara lokale.

Më tej, **duhet të zhvillohen gjithashtu aktivitete rekreative dhe didaktike drejt komuniteteve lokale** për rritjen e ndërgjegjësimit të fshatarëve për të drejtat e tyre të përdoruesit, për përvetësimin e mbarështrimit të burimeve në një mënyrë më të qëndrueshme, për të krijuar ndërveprime të reja midis stafit bashkiak të pyjeve dhe palëve të interesuara lokale, si dhe për fillimin e programeve studimore për edukimin mjedisor.

Administrata Rajonale e Zonave të **Mbrojtura Shkoder**, monitoron dhe vëzhgon zonën e mbrojtur **Parku i Alpeve dhe monumentet e natyrës blirët e lesniqes** në kete ekonomi pyjore dhe ky aktivitet duhet të mbështetet.

VI. Rrugët dhe infrastruktura

VI.1 Rrugët pyjore

Nga vërtetimi në terren brenda kufijve të EP **Shosh 2**, rrjeti rrugor mungon teresisht. Në kontekstin e një tendence intensive të largimit të banorëve nga zonat rurale, ajo që është në rrezik është perspektiva për një zhvillim më të mirë të EP në lidhje me burimet e pyjeve dhe kullotave, por gjithashtu përtej aspekteve ekonomike të përgjithshme (bujqësi, turizëm) edhe atraksioni i përgjithshëm i EP **Shosh 2**.

Lind domosdoshmëria e lidhjes me rrugë ta fshatrave ta zones, si dhe na vijimasi i hapjes sa rrugave auto pyjore me qëllim mbërritshmëria e pyjeve për mundasimin e tyre për futjen në shfrytëzim sipas mundësisë vjetore. Sidoqoftë, interesi i tyre përtej pylltarisë dhe fshatarësisë dihet se siguron një mbërritshmëri më të mirë në vlerat peizazhiste dhe rekreative

VI.2 Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës

Për të përfunduar përmbledhjen mbi strukturat e tjera dhe përdorimet e tokës, duket e dobishme të ilustron me pajisjet e vaditjes dhe furnizimit me ujë, duke pasur parasysh se nuk ka infrastrukture ose objekte shtesë të rëndësishme në lidhje me kullotat dhe pyjet. Sa i përket kullotave, mund të shtohet se **infrastruktura për bagëtinë** përfaqësohet nga lerat, kasollet, si dhe stanet dhe gardhet e ndërtuara për strehimin e bagëtive dhe barinjve gjatë verës.

VII. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat


VII.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

VII.1.1 Analizimi i tipeve pyjore

Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në nivel bashkie dhe japin kontributin kryesor në produktet drusore dhe jodrusore. Gjatë inventarizimit në terren kemi vërejtur se në rastin e cungishtës rreth 34% e sipërfaqes kanë kurordendesi të lartë (0.9-1.0). dhe mesatare 0.6-0.8 rreth 60% kanë kurordendesi rreth 6%. Në rastin e cungishtës në kurordendesim 0.9-1 zënë 62 % dhe me pak në kurordendesite tjera. Kurse në shkurrë pjesa më e madhe kanë një shkallë mbulimi nga 60-80% dhe rreth 100% e tyre. Hollesisht jepen sipas grafikeve


Përqindja e sipërfaqes cunqishte sipas kurordendesise

■ (E ulet 03-05) ■ Mesatare(06-08) ■ E Larte(09-1.0)




Perqindja e sipërfaqes sipas kurordendesise ne Trungishte

■ E Ulet(03-05) ■ Mesatare(06-08) ■ E Larte(09-1.0)



Përqindja e shkurreve sipas shkalles së mbulimit



Volumi mesatar për hektar në nivel ekonomie pyjore arrin **83 m³/ha**, volumi i përgjithshëm **126,958 m³** dhe rritja mesatare vjetore 3.03 m³/ha/vit. Në lidhje me cungishtet duhet theksuar se volumi mesatar është i pranueshëm dhe kjo pasi këto burime pyjore nuk janë përdorur në mënyrë intensive. Prania e grumbujve të rinj ose të pjekur tregon nevojën për ndërhyrje silvikulturore dhe masa shtesë për rimëkëmbjen e sipërfaqeve pyjore. Më poshtë paraqiten rezultatet e analizimit për tipet kryesore të pyjeve të identifikuara gjatë matjeve në secilën parcelë pyjore dhe të dhënat dendrometrike përkatëse.

Të gjitha të dhënat e hollësishme për çdo parcelë dhe n/parcelë dhe sipas tipeve pyjore jepen në shtojcën 2.


VII.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes



Një tjetër aspekt i studimit ka qenë ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes. Ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit siç kërkohet nga udhëzuesi paraqitet më poshtë për secilën formë qeverisje.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m ³)
Trungishte	736	99	72824
Cungishte e Cungishte e perbere	792	68.3	54109
Shkurre	2.5	10	25
Gjithsej	1530.5	83	126,958


VII.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimitarisë së stacionit

Klasa e prodhimit u përcaktua për speciet kryesore, për të cilat ekzistojnë tabelat e prodhimit. Nga vlerësimet rezultoi që 100 % e sipërfaqes pyjore i përket klasës së V-të të prodhimit, gjë që tregon se grumbujt pyjorë me prodhimtari të ulët janë mbizotërues në këto ekonomi pyjore.





Përveç kësaj, ne studiuam gjithashtu edhe ndarjen e sipërfaqes pyjore dhe volumit në këmbë sipas klasave të moshës ku për secilin regjim qeverisjeje grafiket paraqiten më poshtë.



Në rastin e trungishteve, 78 % e sipërfaqes janë grumbuj pyjorë me moshë nga 21-40 vjeçare .Ndersa ne rastin e cungishteve 97 % e sipërfaqes mbulohet nga grumbujt me moshe 21-30 vjet.



Ne rastin e shkurreve klasat e moshes shtrihen deri ne 25 vjeç, ndersa cungishten jane ne klasen e moshes 21-30 vjet dhe me pak ne klasat 31-40 dhe 51-60 vjet. Kjo tregon se ne keto siperfaqe mund te aplikohen prerje perfundimtare duke siguruar nje pjese te mire te materialit drusor per te plotesuar nevojat e popullsise dhe te bashkise per dru zjarri.

Sipërfaqja në hektar sipas specieve dhe klasave të moshës

Në shkurre, Shkoza e zeze (*C.orientalis.*) është specia mbizotëruese, duke zënë 100 % të sipërfaqes dhe me pjesmarre lajthie.

Shkurre




Klasat e moshës	Siperfaqia ne ha e shkurreve sipas llojeve e klasave te moshes						Totali
	Mare	Shqope	Shkoze e zezë	Mrete	Dellinjë e kuqe	Cermedell	
0-5							
6-10							
11-15							
60-20							
21-25	0	0	2.5	0	0	0	2.5
26-30							
31-35							
36-40							
Total			2.5				2.5

Trungishte


Në rastin e trungishteve Ahu (*F.sylvatica*.) dhe Bunga zenë rreth 95 % te siperfaqes,ndersa Pisha e zezë zë vetëm 23.5 ha kurse llojet e tjera jane shoqeruese dhe i perkasin nenpyllit. Pisha është një pyll artificial i krijuar nga stafi pyjeve me nje moshe 43 vjeç bazuar ne numerimin e rratheve te drureve mbizoterues ne grumbull.

Nr	Ilojet	KLASAT E MOSHES TRUNGISHTE												Totali Ilojit	
		1.-20		21.-40		41-60		61-80		81-100		101-120			
		Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.Ha	Volum m3
Lloje shoqeruese nenpylli															
1	SH.Zeze	2.8	94	9.5	352									12.3	446
2	FRB	1.7	97	0	0									1.7	97
Trungishte				0	0									0	0
3	Ah			102.8	12127	19.8	1260	144.6	23539	61.6	9189	13.7	4197	342.5	50311
4	BLA			2.2	98									2.2	98
5	Bung			342.5	19126	0.3	21							342.8	19147
6	PAM			11.1	1065									11.1	1065
7	PIZ			23.4	1660									23.4	1660
Totali		4.5	191	491.5	34428	20.1	1281	144.6	23539	61.6	9189	13.7	4197	736	72824



2	FRB	44.3	2572							44.3	2572
3	BLA	54.3	3989	21.7	1307					76	5296
4	Bung	583.8	41264	60.2	3630			19.9	665	663.9	45559
5	PAM	3.2	386							3.2	386
6	Krekez	4.1	275							4.1	275
Totali		690.2	48486	81.9	4937			19.9	665	792	54109


Volumi më i madh sipas klasave të moshës i përket klasës së moshës nga 21-30 vjeç (89.9 %) dhe volumi më i ulët ne klasat etjera të moshes.



Pyjet Trungishte

Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të moshës në pyjet trungishte zen 67 % në klasë moshes j 21-40 vjec. Këto te dhena tregojnë që ne pyjet trungishte duhet të kryhen trajtime silvikulturore të tipit të rrallimeve e krasitjeve në pishë për të shmangur kalimin e zjarreve nga toka në kurorat e drurëve. Në klasat me të larta të moshes do të nderhyhet me prerje kopshtore.


Nr	Llojet	KLASAT E MOSHES TRUNGISHTE												Totali llojit	
		1.-20		21.-40		41-60		61-80		81-100		101-120			
		Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.Ha	Volum m3
Lloje shoqeruese nenpylli															
1	SH.Zeze	2.8	94	9.5	352									12.3	446
2	FRB	1.7	97	0	0									1.7	97
Trungishte				0	0									0	0
3	Ah			102.8	12127	19.8	1260	144.6	23539	61.6	9189	13.7	4197	342.5	50311
4	BLA			2.2	98									2.2	98
5	Bung			342.5	19126	0.3	21							342.8	19147
6	PAM			11.1	1065									11.1	1065
7	PIZ			23.4	1660									23.4	1660
Totali		4.5	191	491.5	34428	20.1	1281	144.6	23539	61.6	9189	13.7	4197	736	72824



Shkurret

Ne rastin e shkurreve rezulton se pjesa me e madhe e volumit eshte ne klasat e moshes 16-20 vjeç e cila ze 100% te volumit total te shkurreve.

Nr	Llojet	Klasat e moshes shkurre						Totali llojit	
		16-20		21-25		26-30			
		Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.ha	Volum m3	Sip.Ha	Volum m3
1	Sh.Zeze	1.55	15					1.55	15
2	FRB	0.5	5					0.5	5
4	Bung	0.45	5					0.45	5
Totali		2.5	25	0	0			2.5	25



VII.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

VII.2.1 Gjendja e kullotave

Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej **21.9 ha në EP Shosh 2** është ndarë sipas tipeve dhe shkallës së mbulesës barishtore. Tabelat më poshtë evidentojnë gjendjen mesatarisht të pasur të tokave kullosore, duke qenë se e gjithë sipërfaqja kullosore ka një mbulim barishtor mbi 70% dhe pjesëmarrja sipas llojeve është 60% Graminace;30% Lrguminoze dhe 10% te ndryshme.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
Kullotë	21.9
Kullotë me shkurre	0
Kullotë me drurë	0
TOTALI(HA)	21.9

Shkalla e mbulimit me bimësi barishtore (%)	Sipërfaqja e tokës kullimore (ha)
< 20	
60 deri 70	21.9
70 deri 80	
80 deri 90	
90 deri 99	
100%	
Totali(ha)	21.9

Speciet graminore kryesore ne keto kullota janë: *Dactylis glomerata*, *Poa annua* dhe *Avena fatua*. Një kufizim tjetër është prania e gurëve, e cila ndikon ne prodhimtarine e kullotave.

Shkalla e mbulimit me gurë	Sipërfaqja e tokës kullimore (ha)
E ulët < 30%	
E moderuar 31-60%	21.9
E lartë > 60%	
Totali (ha)	21.9

Lidhur me presionin mbi sipërfaqen kullimore dhe mbulimin e kufizuar me vegetacion, përparësi është funksioni mbrojtës ndaj atij prodhues.

VII.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullimore

Saktësimet mbi sipërfaqen kullimore në parcela dhe n/parcela, vendndodhjen e tyre, duke iu referuar qytetit/fshatit kryesor dhe përdorimin e tyre (kryesisht të përbashkët) jepen në tabelën vijuese.

Parcela,kodi	N/parcela	Sipërfaqj (ha)	Njësia administrative	Mënyra e përdorimit
Sh67 00 041	041c	2.97	Temal	Përbashkët
Sh67 00 043	043b	0.59	Temal	Përbashkët
Sh67 00 086	086b	0.72	Temal	Përbashkët
Sh67 00 086	086c	0.79	Temal	Përbashkët
Sh67 00 086	086d	0.68	Temal	Përbashkët

Parcela,kodi	N/parcela	Sipërfaqj (ha)	Njësia administrative	Mënyra e përdorimit
Sh67 00 086	086e	0.87	Temal	Përbashkët
Sh67 00 87	087b	1.46	Temal	Përbashkët
Sh67 00 088	088b	2.09	Temal	Përbashkët
Sh67 00 088	088c	0.57	Temal	Përbashkët
Sh67 00 095	095c	11.16	Temal	Përbashkët
TOTALI		21.9		

VII.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Te dhenat per lartësinë mbi nivelin e detit, pjerrësinë dhe kundrejtimin në mënyrë të përgjithshme për secilën parcelë që përdoret për kullotë jepet ne tabelen e mëposhtme.

Parcela/ nenparcela	Sipërfaqja (ha)	Kundrejtimi	Altituda mesatare (m)	Pjerrësia mesatare (%)
Sh67 00 041c	2.97	L	1176.396028	24.18522003
Sh67 00 043b	0.59	J	697.3213022	24.07428233
Sh67 00 086b	0.72	JL	1375.533955	34.05263277
Sh67 00 086c	0.79	J	1396.580071	23.29105595
Sh67 00 086d	0.68	VL	1299.414673	6.113203547
Sh6700s086e	0.87	JL	1266.7748	23.11644016
Sh67 00 087b	1.46	VL	1257.998056	11.89407809
Sh67 00 088b	2.09	JP	1289.623976	18.37469101
Sh67 00 088c	0.57	JP	1342.83883	14.98442926
Sh67 00 095c	11.16	L	1265.151611	35.37921366
Shuma	21.9			

VII.2.4 Mbërritshmëria

Sipërfaqja kullosore nuk ka nje mbrritshmëri me rruge auto, por me rrugë këmbësore.

VII.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota

Ne kete ekonomi nuk kemi konstatuar djegie te kullotave.

VIII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave

VIII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

VIII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i Shosh 2 u krye gjatë muajit Korrik- shtator 2024 . Ai u bazua në matjet e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme te vendosura sipas nje rrjeti te baraslarguar sistematik për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshëm. Gjithsej u matën 516 sipërfaqe provë, ku 90% e totalit të sipërfaqeve provë u morën në pyje (shkurre, cungishte, trungshte) dhe 8.7 % në sipërfaqe jopyjore (bimesi pyjore ,inproduktive) dhe kullota 0.3%.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë
Pyll	464
Kullotë	7
Sipërfaqe jo pyjore	0
E pambërritshme	45
Gjithsej	516

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për të kompletuar inventarizimin.

Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rraphë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m², 200 m² dhe 400 m², në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m² u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve ishte nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m²) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m²) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm. Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përlogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësuaam parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm \sqrt{S_x^2}$$

$$S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^n x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^n x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koeficienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{x} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ishte **9.2 %**. Ky gabim është jodomethënës, që do të thotë se të dhënat e volumit tësiguruara nga inventarizimi në terren janë 129,191 m³ brenda kufirit të gabimit (± 20 %).

Numri i sipërfaqeve provë	516
Volumi mesatar (m ³ /ha)	81.74
Shmangia standard	20
Koeficienti i variacionit	
Gabimi standard (m ³)	11890
Gabimi standard (%)	9.2

VIII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Rezultatet e inventarizimit të pyjeve treguan që sipërfaqja pyjore e EP **Shosh 2** është **1530.5 ha**. Volumi në këmbë është **126,958 m³**, ekuivalent me **82.95 m³/ha**.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë(m ³)	Rritja mesatare vjetore (m ³ /ha/vit)
Trungishte	736	98.94	72824	3.07
Cungishte Thj.Perbere	792	68.32	54109	2.99
Shkurre	2.5	10	25	14.04
Gjithsej	1530.5		126958	3.07

Krahas kësaj, vlerësuam volumin e asortimenteve për pyjet. Nga vlerësimet rezultoi që drute e zjarrit janë asortimenti drusor kryesor në cungishte dhe zë 79% të volumit në kembe, në cungishte mbizotëron lenda e punimit me 56 %. Me hollësisht jepen në tabelën më poshtë.

Forma e menaxhimit/Regjimi	Sip.ha	Volumi në ekembë m ³	Përqindja e asortimenteve				Volumi në m ³ sipas asortimenteve					Total m ³
			E trash e m ³	E mes me m ³	E hollë m ³	Dru zjarri m ³	E trashe m ³	E mesme m ³	E holle m ³	Total l.Pumin mi m ³	Dru zjarri m ³	
Trungishte	736	72824	12.56	16.58	27.22	43.64	9146.7	12074.2	19822.6	41043.5	31780.5	72824
Cungishte	792	54109	0	1.6	18.64	79.76	0	865.7	10086	10951.7	43157.3	54109
Shkurre	2.5	25	0	0	0	100	0	0	0	0	25	25
Totali	1530.5	126958					9146.7	12939.9	29908.6	51995.2	74962.8	126958

Bazuar në mostrat e drurëve të marrë brenda sipërfaqeve provë me anë të tyre të lës, u bë matja e rritjes së drurëve për 10 vitet e fundit. Rezultatet e rritjes mesatare vjetore për 1 ha në nivel ekonomie pyjore treguan se kjo rritje është 3 m³/ha/vit, ndërsa rritja vjetore për të gjithë ekonominë ishte 4664.8 m³/vit.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Rritja mesatare vjetore (m ³ /ha/vit)	Rritja vjetore në Volum (m ³ /vit)
Trungishte	736	3.07	2265.1
Cungishte	792	2.99	2368.2
Shkurre	2.5	14.04	35.2
Gjithsej	1530.5		4664.8

VIII.1.3 Struktura vertikale

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ekipet e terrenit në vlerësuam shpërndarjen e strukturës vertikale sipas parcelave pyjore (shih tabelën e mëposhtme). Vërejtëm që në 100% të sipërfaqeve provë, grumbujt pyjorë kanë strukturë vertikale me 1 katë.

Struktura vertikale	Sipërfaqja(ha)	%
Njëkatëshe	1530.5	100
Dykatëshe		
Shumëkatëshe		
Gjithsej	1530.5	100

Klasifikimi i grumbujve pyjorë sipas strukturës vertikale jepet hollësisht në shtojcën 3.

VIII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Vlerësimi racional dhe kompleks i lëndës drusore kërkon njohuri të hollësishme të cilësisë së grumbujve pyjorë, jo vetëm në drejtim të volumit të përgjithshëm, por gjithashtu edhe në drejtim të vlerësimit të asortimenteve. Ky klasifikim është realizuar nga raporti i volumit të drurëve ekuivalentë me klasën e parë të cilësisë ndaj volumit të përgjithshëm. Kjo hipotezë vërtetohet kur kemi parasysh vetëm drurët e kategorisë së diametrave qendrorë, të cilët kanë peshën më të madhe në vëllimin e përgjithshëm të grumbujve pyjorë. Megjithatë nuk ka ndonjë vlerësim të cilësisë nga ekipet e inventarizimit në terren, në vlerësimin e cilësisë ne bazohemi në raportin e lëndës së punimit dhe druve të zjarrit ndaj volumit të përgjithshëm bazuar në tabelën e mëposhtme:

Klasa e cilesise	Kriteret e percaktimit
3	Lenda e punimit ze me pak se 60% te volumit per haloret dhe 30% per fletoret. <i>(dru zjarri (trung me cilesi te dobet dhe nuk perdoret per qellim industrial) (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore < 10%; fletore < 10%). Ne kete rast lenda e punimit ze 15% te volumit kurse drute e zjarrit 85% te volumit).</i>
2	Lenda e punimit ze 61 - 80 % te volumit per haloret dhe 30 - 50 % per fletoret. <i>(trungu ka nje gjatesi nga 2 deri ne 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore >10- 60% (83% lende punimi+17% dru zjarri); fletore > 10-50% (64% lende punimi + 36% dru zjarri).</i>
1	Lenda e punimit ze > 80 % te volumit per haloret dhe > 50 % per fletoret. <i>(Eshte i cilesise se mire dhe ka nje gjatesi minimale prej 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore > 60% (98% lende punimi + 2 % dru zjarri; fletore > 50% (83% lende punimi + 17% dru zjarri).</i>

Bazuar në raportin e volumit të lëndës së punimit ndaj volumit të përgjithshëm, duke iu referuar tabelës së mësipërme ne bëjmë vlerësimin e përqindjes së secilit asortimenteve për secilin ngaster dhe me pas llogaritem volumin e asortimenteve sipas fletoreve dhe haloreve.

Asortimentet	Fletore		Halore	
	Volumi(m3)	%	Volumi(m3)	%
L.trashe	9146.7	7.3		

L.mesme	12939.9	10.32		
L.Holle	29493.6	23.54	415	25
Dr.Zjarri	73717.8	58.84	1245	75
Totali	125,298	100	1,660	100

Forma e menaxhimit/ Regjimi	Sip.ha	Volumi n ekembë m ³	Përqindja e asortimenteve				Volumi ne m3 sipas asortimenteve					Total m ³
			E trash e m ³	E mes me m ³	E hollë m ³	Dru zjarri m ³	E trashe m ³	E mesme m ³	E holle m ³	Total I.Pumin mi m ³	Dru zjarri m ³	
Trungishte	736	72824	12.56	16.58	27.22	43.64	9146.7	12074.2	19822.6	41043.5	31780.5	72824
Cungishte	792	54109	0	1.6	18.64	79.76	0	865.7	10086	10951.7	43157.3	54109
Shkurre	2.5	25	0	0	0	100	0	0	0	0	25	25
Totali	1530.5	126,958					9146.7	12939.9	29908.6	51995.2	74962.8	126958

Vlerësimet tona treguan që grumbujt pyjorë fletore në EP Shosh 2 i përkasin klasës së II të cilësisë pasi lenda e punimit ne fletore ze 41% dhe drute e zjarrit 59%. **Ne rastin e grumbujve me halore ku lenda e punimit zuri 25% dhe drute e zjarrit 75% dhe sipas klasifikimit te mesiperm keta grumbuj bejne pjese ne klasen e 3-te te cilesise. Por ky vlerësim nuk është ende i mjaftueshëm, pasi duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me vlerësimin e lëndës drusore me fokus kryesor tek anomalitë, plagët, nyjet, etj.**

VIII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)

Pyjet dhe shkurret në EP Karmaluajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore ne përdorëm të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorëm të dhënat e dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore për secilin regjim qeverisje:

- Ahun për pyjet trungishte
- Bungun për pyjet cungishte
- Shkozen e zeze për shkurret

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO₂ u bë duke u bazuar në peshën molekulare (CO₂/C = 44/12 = 3.667).

Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorëm ekuacionin e mëposhtëm:

$$B_{mbt} = V_{total} \times Dd \times C_{ratio} \times BEF$$

ku:

V_{total} – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D_d – dendësia e peshës së thatë

C_{ratio} – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF_Faktori i ekspansionit të biomasës

Regjimi i qeverisjes	Sip.(Ha)	Volumi (m3)	Dendësia baze e drurit(kg/m3)	Peshe e thatë(ton)	BEF	Biomasa mbitoksore(ton)	Pesha e C(ton)	Pesha e CO2(ton)
0								
Trungishte	736	72824	550	40,053,2	1.34	53,671.2	26,835.6	98,406.1
Cungishte	792	54109	720	38,958,4	1.4	54,541.7	27,270.85	100,002.2
Shkurre	2.5	25	800	20.0	1.31	26.2	13.1	48
Totali	1530.5	126958		79,037		108,239.1	54,119.55	198,456.3

VIII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

EP Shosh 2 ka një sipërfaqe prej **1530.5** ha dhe burime të këtilla luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Bazuar në të dhënat nga inventarizimi i pyjeve, sasia e CO₂ të sekuestruar nga burimet pyjore në këte ekonomi rezultoi **198,456.3 ton**. Nëse marrim parasysh rritjen mesatare vjetore të pyjeve (**4664.8 m³/year**), sasia e CO₂ që depozitohet çdo vit është **8878 ton**. Kjo sasi pritej të ishte më e lartë nëse burimet pyjore në **EP Shosh 2** do mbarështroheshin në mënyrë të qëndrueshme. Të gjitha prerjet e paligjshme dhe lënda drusore e djegur nga zjarret në pyje konsiderohen si rrjedhje, prandaj për këto arsye CO₂ aktual i depozituar është më i ulët se sa kapaciteti depozitues natyral. Megjithëse kjo EP ka një sipërfaqe të vogël pyjesh, këto burime pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale dhe ofrojnë shumë shërbime mjedisore, siç janë sekuestrimi i karbonit, qarkullimi i elementëve ushqyes, mbajtja e ujit, cilësia dhe strehimi i kafshëve, etj.

VIII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Në grumbujt pyjore të kësaj ekonomie **nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.**

Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen**, duke marrë në konsideratë kushtet specifike të EP Karma-Çarçovë, të karakterizuara nga një

ndryshueshmëri e altitudës, kundrejtimit dhe klimës. Prandaj mund të thuhet që dëmet kryesore janë shkaktuar nga burime të tjera: mbikullotja, zjarret në pyje, prerjet e paligjshme.

VIII.2.1 Drurët e tharë

Nuk kemi konstatuar drure të thara me përjashtim të disa rasteve të aheve si pasoje të zjarreve.

VIII.2.2 Dëmtimet të tjera

Duke iu referuar rubrikës “dëmtimet” lidhur me të dhënat e grumbulluara gjatë inventarizimit, të cilat janë të lidhura me ato të rubrikës “rreziku për biodiversitetin” (shih pjesën V.8 për saktësim), janë dhënë rezultate të përgjithshme. Më tepër dëmtimet janë shkaktuar nga prerjet e paligjshme, dhe mbikullotja .

Në rastet më të rënda të shfrytëzimit intensiv apo djegies së pyjeve, **ndikimet mund të vënë në pikëpyetje kapacitetin e ekosistemit për të mbajtur veten në të ardhmen** në statusin e pyllit ose kullotës dhe ofrimin e shërbimeve shoqërisë (përfshirë shërbimet mjedisore dhe sociale dhe mbrojtjen ndaj rreziqeve natyrore në zonat malore).

Kjo është arsyeja se pse zhvillimi i funksionit mbrojtës të ekosistemeve pyjore dhe kullimore është një nga qëllimet kryesore të këtij plani mbarështrimi, në përputhje me objektivat e tjerë kryesorë, siç janë rritja e sasisë dhe cilësisë së kapitalit të lëndës drusore në pyje.

VIII.3 Prerjet e paligjshme

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme janë prezente në disa ngastrat, kryesisht në ngastrat e veshura me Ah. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje për të plotësuar nevojat e saj për dru zjarri ose për gardhe, hunj etj presin një pjesë të materialit drusor në keto ngastrat pyjore. Në këtë mënyrë ata synojnë të presin drurët me dimensionet më të mëdha.

Në këto rrethana, ndërhyrjet e bashkërenduara më mirë ndërmjet stafit të shërbimit pyjor bashkiak dhe banorëve janë një faktor kyç për të zvogëluar shkatërrimin e shkaktuar nga këto prerje informale. Si përparësi, fshatarët duhet të instruktohen të rrallojnë pyllin në formën e një ndërhyrje silvikulturore të përshtatshme, duke hequr drurët e thatë, të nënshtruarit dhe të shtrembërit. Presioni mbi burimet pyjore duhet, gjithashtu, të përqëndrohet në përdorimin e materialit drusor që rezultojnë nga prerjet silvikulturore.

Prandaj është thelbësore që zbatimi i këtij plani mbarështrimi të pasohet nga një bashkërendim më i mirë ndërmjet aktorëve në bashki dhe nga një strategji specifike e zhvilluar për kontrollin e aktiviteteve të prerjeve në pyjeve.

VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Rezultatet e analizës të paraqitura në pjesët V.4 dhe VII.4 mund të përmbliken si në vijim. **Kullotat zënë një sipërfaqe prej 21.9 ha në EP Shosh 2.** Ato shtrihen në vazhdimësi të sipërfaqeve pyjore dhe kanë të njëjtat kushte gjeomorfologjike si pyjet. Të gjitha kullotat janë verore, duke përfshirë sipërfaqet me mbulim barishtor që vegjetojnë nga muaji Maj deri në muajin Shtator/Tetor, si edhe pas shirave që bien gjatë verës dhe vjeshtës. Keto sipërfaqe kanë një pjerrësi 16 grade. **Në drejtim të prodhimtarisë, kullotat janë relativisht të pasura,** me një përbërje të mirë të specieve graminore dhe leguminoze. Prodhimtaria e kullotës do ishte me e mirë nëse një pjesë e sipërfaqes së saj nuk do të mbulohej nga gurët.

Mungesa e rregullimit dhe racionalizimit në lidhje me blegtorinë çon në dëmtime serioze: mbikullotje; prani të erozionit ndonjëherë, erozion në thellësi; kullotje të pakontrolluar në tokat pyjore ku konsumohet gjethi dhe pengohet ripërtëritja.

VIII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit

Kullotat përdoren kryesisht gjatë gjithë vitit, duke qenë se altituda e tyre është e ulët dhe debora në këte ekonomi mungon. Pothuajse të gjithë përdoruesit janë banorë të fshatrave në afërsi të sipërfaqes kullimore në referencë të të drejtave të tyre të njohura zyrtarisht.

VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Shumica e kafshëve përfaqësohet nga të leshtat, të dhirtat dhe gjedhët, pasi është më i lehtë mbarështimi i këtyre llojeve, duke qenë se njerëzit kryesorë që merren me blegtori janë të moshuarit. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të fortë demografike, numri i bagëtive, të cilat zakonisht vlerësohen të jenë për nevojat e banorëve ka pësuar rënie. Në sasi, numri aktual i bagëtive ditët e sotme vlerësohet të jete zvogeluar me rreth 50%. **Kjo rezulton në një ulje domethënëse të presionit të kullotjes mbi burimet pyjore, megjithëse ekuilibri ndërmjet numrit të bagëtive dhe kapacitetit mbajtës është ende larg për t'u arritur.**

VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është “çdo fshat brenda kufijve të tij”. Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullimore është përgjithësisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 0.5 gjedhë, 3 dhi dhe 4 dele që mund të kullotin pa i shkaktuar dëme serioze pyllit apo ekosistemit.**

VIII.4.5 Infrastruktura aktuale

Infrastruktura kullosore është e pakët. Prania e koritave prej druri apo çezmave të ndërtuara afër burimeve që shërbejnë si rezerva ditore për pirjen normale, përveç përrenjve sezonale, nuk duhen neglizhuar dhe duhet investuar për to. Infrastruktura tjetër si rrjeti rrugor, gardhimet, sinjalistika, shenjat treguese të ndryshme për informim gjatë sezonit të kullotjes mungojnë plotësisht.

VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë

Nga vërtetimi në terren rezultoi se **rezerva ushqimore në kullote është e vogël, që do të thotë një mbikullotje e përgjithshme në pyjet dhe kullotat e kësaj ekonomie**. Ky është një shpjegim i qënësishëm i rritjes së presionit blegtoral mbi burimet pyjore dhe mbi ripërtëritjen e tyre, pasi çobenjtë kërkojnë për furnizim me bazë ushqimore shtesë për bagëtitë që e sigurojnë nga gjethi nëpërmjet krasitjes së degëve në mënyrë të pakontrolluar. **Në zonat më të ndjeshme, masa parësore që duhet marrë është ndalimi i kullotjes nëpërmjet një kontrolli më të mirë të bagëtive ose edhe duke i rrethuar me gardhe, në mënyrë që vegjetacioni i degraduar dhe mbulesa pyjore të mund të ripërtërihet brenda 5 viteve.**

